



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 67

Tiranë – E mërkurë, 4 maj 2022

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 13574, datë 26.4.2022	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 8543
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 253, datë 29.4.2022	Për transferimin në pronësi të Bashkisë Mirditë të pasurisë nr. 2/134, zona kadastrale 3224, Mirditë, për Njësinë Administrative Rrëshen, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 359, datë 5.6.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Shërbimit Informativ Shtetëror”, të ndryshuar..... 8543
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 254, datë 29.4.2022	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 191, datë 15.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Agjencisë për Zhvillimin Ekonomik Rajonal të godinave dhe truallit funksional të tyre, ndodhur në zonën kadastrale 8210, me numër pasurie 3/74, me sipërfaqe 5044.85 m ² , dhe me numër pasurie 3/183, me sipërfaqe 1580.89 m ² ”..... 8546
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 255, datë 29.4.2022	Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rforcimit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Durrës..... 8546
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 273, datë 29.4.2022	Për një ndryshim në vendimin nr. 78, datë 28.1.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin e ligjit nr. 150/2014, datë 6.11.2014, ‘Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë’”, të ndryshuar..... 8547
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 278, datë 29.4.2022	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Sistemi rrugësh, blloku ‘Përroi i Çaprazit’, Pogradec”..... 8547
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 279, datë 29.4.2022	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 658, datë 8.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi i Rrugës së Elbasanit (Fakulteti Filologjik – Unaza e Madhe e Tiranës)”, të ndryshuar..... 8549

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 280, datë 29.4.2022	Për përcaktimin e rregullave dhe kriterëve të detajuara për kushtet teknike, sigurinë, përshtatshmërinë dhe aksesueshmërinë nga personat me aftësi të kufizuara, që duhet të plotësojnë ndërtesat e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale.....	8550
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 283, datë 29.4.2022	Për masat menaxhuese të ruajtjes së burimeve peshkore dhe përfshirjen e institucioneve në marrjen dhe zbatimin e tyre.....	8571
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 284, datë 29.4.2022	Për përcaktimin e rregullave, procedurave dhe kriterëve për pajisjen me certifikatën e ekspertit në fushën e pyjeve dhe kullotave.....	8573
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 29.4.2022	Për kriteret e vendosjes dhe të funksionimit të stacioneve sezonale të ankorimit/bregëzimit.....	8578
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 287, datë 29.4.2022	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2022, miratuar për Ministrinë e Kulturës, për Bashkinë Tiranë, për financimin e projektit “Tirana, kryeqyteti evropian i rinisë 2022”.....	8581
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 182, datë 19.4.2022	Për përcaktimin e sasive minimale të lejueshme që mund të hidhen në det për disa forma të peshkimit të pelagjikëve të vegjël.....	8581
Urdhër i Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 61, datë 28.4.2022	Për delegim kompetence.....	8582
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 31.3.2022	Çështja Ardian Kalia kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 62986/09</i>).....	8582



DEKRET

Nr. 13574, datë 26.4.2022

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 13, 14, 20 dhe në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Krenar Alo Saliasi
2. Mirela Musa Dashi (Ajdini)
3. Albor Përparim Metaliaj
4. Erjon Pajtim Senkaj
5. Silvana Zenel Mehmetaj
6. Keivin Fatmir Muçja
7. Erlind Gjetë Gjonaj
8. Noah Erlind Gjonaj
9. Modena Imtjaz Gjonaj (Bajraktari)
10. Ermal Engjëll Veli
11. Reis Rasim Kurti
12. Shkëlzen Prend Marku
13. Angjelin Dedë Shpella
14. Jonida Zabit Dhima (Dervishi)
15. Julinda Julian Dhima
16. Marilena Julian Dhima
17. Bekim Fisnik Hoxha
18. Herisa Petro Thanasi (Palla)
19. Iris Elton Thanasi
20. Vanina Fisnik Hoxha
21. Griselda Nderim Ademi (Lumaraku)
22. Kujtim Gjini Gjini
23. Denada Shaban Pasholli
24. Katina Panajot Boçi
25. Art Haxhi Brahaj
26. Enkela Kujtim Neza
27. Luan Ibrahim Biba
28. Kristina (Christina) Andrea Paço (Paco/Patso)
29. Ingrid Agron Kaso

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

VENDIM

Nr. 253, datë 29.4.2022

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË
BASHKISË MIRDITË TË PASURISË
NR. 2/134, ZONA KADASTRALE 3224,
MIRDITË, PËR NJËSINË
ADMINISTRATIVE RRËSHEN, DHE
PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 359, DATË 5.6.2003, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE
TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË
CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI SHËRBIMIT
INFORMATIV SHTETËROR”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 14 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi, nga Shërbimi Informativ i Shtetit të Bashkia Mirditë, për njësinë administrative Rrëshen, të pronës, me emërtimin “Godinë 3 kate zyra”, Rrëshen, me numër pasurie 2/134, zona kadastrale 3224, Mirditë, sipas formularit dhe planrilevimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi, me qëllim ushtrimin e funksioneve në fushën e shërbimeve sociale dhe për infrastrukturë rrugore.

2. Prona, me emërtimin “Godinë 3 kate zyra”, hiqet nga lista e inventarit, që i bashkëlidhet



vendimit nr. 359, datë 5.6.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.


3. Bashkisë Mirditë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pasurisë së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Bashkia Mirditë dhe Shërbimi Informativ i Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Arben Ahmetaj





1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

Bashkia Mirditë										
Fusha e perdorimit të Prones: Në fushën e Shërbimeve Sociale dhe Infrastrukturës Rrugore										
A				B			C			
Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te vecanta)
1	3224 RRE-C-2	2/134	Truall dhe Ndertese	Godinë 3 (tre) kate zyra Adresa: Rr. "Dijes", Ndërtesa 10, qyteti Rrëshen, 4601, Bashkia Mirditë	524	154	Në fushën e Shërbimeve Sociale	Bashkia Mirditë	Bashkia Mirditë	Ky objekt është tre (3) kate, me sipërfaqe ndërtimi 422 m2 dhe jashtë funksionit si zyra.
2	3224 RRE-C-2		Truall	Infrastrukturë Rrugore	42		Në fushën e Infrastrukturës Publike	Bashkia Mirditë	Bashkia Mirditë	Infrastrukturë rrugore, pjesë përbërë e Rr. "Dijes"

Identifikoi: Erlinda Doda (Specialiste asetesh)

Supervizoi: Adelina Dukaj (Drejtor i Planifikimit dhe Zhyllimit të Territorit)

Aprovoi: Ndreç DEDAJ (Kryetari i Bashkisë Mirditë)

**VENDIM****Nr. 254, datë 29.4.2022**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 191, DATË 15.3.2017,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI TË AGJENCISË PËR
ZHVILLIMIN EKONOMIK RAJONAL TË
GODINAVE DHE TRUALLIT
FUNKSIONAL TË TYRE, NDODHUR
NË ZONËN KADASTRALE 8210, ME
NUMËR PASURIE 3/74, ME SIPËRFAQE
5044.85 m², DHE ME NUMËR PASURIE
3/183, ME SIPËRFAQE 1580.89 m²”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 14, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 191, datë 15.3.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në titull dhe kudo në vendim, emërtimi “Agjencisë për Zhvillimin Ekonomik Rajonal” zëvendësohet me “Fondit Shqiptar të Zhvillimit”.

2. Në titull, pas fjalëve “... me sipërfaqe 1 580.89 m² ...” shtohen fjalët “... dhe me numër pasurie 3/389, me sipërfaqe 56 m² ...”.

3. Në fund të pikës 1 hiqen fjalët “... me qëllim zhvillimin e projektit “Qendra multifunksionale e shërbimeve për sipërmarrjet e reja “Betahaus Tërirana” ...”.

4. Pas pikës 1 shtohen pikat 1/2 dhe 1/3, me këtë përmbajtje:

“1/2. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Fondit Shqiptar të Zhvillimit të ndërtesës me sipërfaqe të përgjithshme 498.6 (katërqind e nëntëdhjetë e tetë pikë gjashtë) m², e cila pozicionohet në pasurinë nr. 3/74, me sipërfaqe 363.1 (treqind e gjashtëdhjetë e tre pikë një) m², në pasurinë 3/183, me sipërfaqe 79.5 (shtatëdhjetë e nëntë pikë pesë) m², dhe në pasurinë nr. 3/389, me sipërfaqe 56 (pesëdhjetë e gjashtë) m², ndodhur në zonën kadastrale 8210, Tiranë, sipas planrilevimit, bashkëlidhur këtij vendimi.

Faqe | 8546

1/3. Fondit Shqiptar të Zhvillimit i ndalohej ta tjetërsojë pronën ose ta japë në përdorim të tretët që nuk janë struktura apo subjekte në varësi të Fondit Shqiptar të Zhvillimit”.

II. Ngarkohen Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj**

VENDIM**Nr. 255, datë 29.4.2022**

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
RIFORCIMIT TË NJËSIVE
INDIVIDUALE TË BANIMIT DHE
NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA
(PALLAT), NË BASHKINË DURRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nëndarja “i”, 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 1 633 906 424 (një miliard e gjashtëqind e tridhjetë e tre milionë e nëntëqind e gjashtë mijë e katërqind e njëzet e katër) lekë pa TVSH, nga Bashkia Durrës, për financimin e rindërtimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) dhe njësive individuale të banimit, të cilat janë klasifikuar si objekte të pabanueshme ose të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni.

2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2022, në masën 326 781 285 (treqind e njëzet e gjashtë milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e një mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, i cili do



të përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë.

3. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

VENDIM
Nr. 273, datë 29.4.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 78, DATË 28.1.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 150/2014, DATË 6.11.2014, ‘PËR PENSIONET E PUNONJËSVE QË KANË PUNUAR NË MINIERA, NË NËNTOKË’”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10, të ligjit nr. 150/2014, datë 6.11.2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Paragrafi i parë, i pikës 1, të kreut III, të vendimit nr. 78, datë 28.1.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, si më poshtë vijon:

“Në zbatim të nenit 7, të ligjit nr. 150/2014, datë 6.11.2014, pensioni i pleqërisë për punonjësit që kryejnë procese pune në miniera, në nëntokë, jepet me kërkesën e të interesuarit, i cili e paraqet atë së bashku me dokumentacionin përkatës, përmes portalit qeveritar “e-Albania”, ndërsa dokumentet shoqëruese dërgohen përmes shërbimit postar pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore ku ka vendbanimin.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

VENDIM
Nr. 278, datë 29.4.2022

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI “SISTEMIM RRUGËSH, BLOKU ‘PËRROI I ÇAPRAZIT’, POGRADEC”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Sistemim rrugësh, blloku “Përroi i Çaprazit”, Pogradec”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Pogradec.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit tokë “truall”, me vlerë 23 003 616 (njëzet e tre milionë e tre mijë e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 23 003 616 (njëzet e tre milionë e tre mijë e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekësh, përballohet nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi i pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në “Fletoren zyrtare” dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasqyruar në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për



efekt shpronësimi, pasi paraqesin certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit pranë Bashkisë Pogradec.

8. Bashkia Pogradec kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Pogradec.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Pogradec, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit, mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe bën regjistrimin e kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuar, në favor të Bashkisë Pogradec.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Pogradec, pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë në favor të Bashkisë Pogradec.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Pogradec, dhe Bashkia Pogradec për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE QË SHPRONËSOHEN NGA PROJEKTI:
“Sistemim rrugësh blloku ‘Përroi i Çaprazit’, Pogradec
Çmimi për pasurinë truall sipas vendimit nr. 89, datë 3.2.2016.

Nr.	Emër Mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pronës	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera	Konfirmimi nga ZVRPP-ja
1	Sotirag Kristani, Violeta Keci, Arben keci, Kristaq Keci	8582	13/322	truall	m ²	368	10491	3,860,688	Certifikatë pronësie
2	Sofije Dervishi	8582	13/175	truall	m ²	209.5	10491	2,197,865	Certifikatë pronësie
3	Nazime Aliçkolli	8582	13/285	truall	m ²	174.6	10491	1,831,729	Certifikatë pronësie
4	Nazime Aliçkolli	8582	13/286	truall	m ²	117.4	10491	1,231,643	Certifikatë pronësie
5	Roza Taro	8582	13/122	truall	m ²	115.4	10491	1,210,661	Certifikatë pronësie
6	Adriana Llakmani, Lirika Llakmani, Meri Llakmani	8582	13/117	truall	m ²	100	10491	1,049,100	Certifikatë pronësie
7	Naumçe Marko, Kostaq Marko, Marie Hasho, Violentina Bixheku, Vlash Tiri	8582	14/146	truall	m ²	197	10491	2,066,727	Me shkresën nr. 5976/1, datë 13.8.2018, ZVRPP Pogradec (ASHK) ka dërguar kartelën dhe hartën treguese për pasurinë nr. 14/217, ZK 8582
8	Flamur Merollari, Lulezim Merollari	8582	14/217	truall	m ²	40.8	10491	428,033	Certifikatë pronësie
9	Sotirag Todi Mato, Kristaq Todi Mato dhe Virxhil Mato	8582	14/471	truall	m ²	870	10491	9,127,170	Certifikatë pronësie
Shuma totale e shpronësimit						2192.7		23,003,616	



VENDIM
Nr. 279, datë 29.4.2022

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 658, DATË 8.10.2014,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR
SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA
REALIZIMI I PROJEKTIT “ZGJERIMI I
RRUGËS SË ELBASANIT (FAKULTETI
FILOLOGJIK-UNAZA E MADHE E
TIRANËS)”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 658, datë 8.10.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 3, vlera e përgjithshme e shpronësimit të pronarëve ndryshon nga “150 563 038.8 (njëqind e pesëdhjetë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e tridhjetë e tetë pikë tetë) lekë” në “152 588 338.8 (njëqind e pesëdhjetë e dy

milionë e pesëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e treqind e tridhjetë e tetë pikë tetë) lekë”.

2. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 152 588 338.8 (njëqind e pesëdhjetë e dy milionë e pesëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e treqind e tridhjetë e tetë pikë tetë) lekësh përballohet, si më poshtë vijon:

a) vlera prej 150 563 038.8 (njëqind e pesëdhjetë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e tridhjetë e tetë pikë tetë) lekësh përballohet nga buxheti i vitit 2014, zëri “Shpronësime”, miratuar për Autoritetin Rugor Shqiptar;

b) vlera prej 2 025 300 (dy milionë e njëzet e pesë mijë e treqind) lekësh përballohet nga buxheti i Autoritetit Rugor Shqiptar.”.

3. Në pikën 5, vlera e shpenzimeve procedurale, prej 211 500 (dyqind e njëmbëdhjetë mijë e pesëqind) lekësh, zëvendësohet me vlerën prej 261 500 (dyqind e gjashtëdhjetë e një mijë e pesëqind) lekësh, e cila përballohet nga buxheti i miratuar për Autoritetin Rugor Shqiptar.

4. Tabelave bashkëlidhur vendimit në fuqi i shtohet tabela, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

LISTA E PRONARËVE PRONË PRIVATE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I PROJEKTIT PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 658, DATË 8.10.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “ZGJERIMI I RRUGËS SË ELBASANIT (FAKULTETI FILOLOGJIK-UNAZA E MADHE E TIRANËS), I NDRYSHUAR

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	ZK	Nr. i pasurisë	Sipërf. e përgj. truall m ²	Sipërf. e prekur truall m ²	Çmimi për truall (lekë/m ²)	Vlera e truallit	Lloji i pasurisë	Vlera e përgjithshme	Adresa	Shënime
1	Besim Valteri	8190	11/1423	163.72	60	33755	2,025,300.00	truall	2,025,300.00	Torre Drinit Njësia 4	Konfirmuar nga ASHK-ja
Vlera totale									2,025,300		



VENDIM

Nr. 280, datë 29.4.2022

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
DHE KRITEREVE TË DETAJUARA PËR
KUSHTET TEKNIKE, SIGURINË,
PËRSHTATSHMËRINË DHE
AKSESUESHMËRINË NGA PERSONAT
ME AFTËSI TË KUFIZUARA, QË
DUHET TË PLOTËSOJNË NDËRTESAT
E INSTITUCIONEVE TË
EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE
PENALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekt i këtij vendimi është përcaktimi i rregullave dhe kriterëve të detajuar për kushtet teknike dhe sigurinë, që duhet të plotësojnë ndërtesat e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, si dhe kriteret për përshtatshmërinë dhe aksesueshmërinë e tyre nga personat me aftësi të kufizuara.

Neni 2

Qëllimi

Ky projektvendim ka për qëllim përcaktimin e rregullave bazë mbi të cilat projektohen, ndërtohen ose rikonstruktohen institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, në kuadër të unifikimit të kushteve teknike dhe sigurisë, si dhe eliminimit të pengesave të cilat përbëjnë burim vështirësish për lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara.

Neni 3

Fusha e zbatimit

Rregullat dhe kriteret e përcaktuara në këtë vendim zbatohen për institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të cilat projektohen, ndërtohen ose rikonstruktohen.

Neni 4

Përkufizime

Në kuptim të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. **“Aksesueshmëri”**, mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve.

2. **“Pengesë”**, janë:

a) pengesat fizike si burim vështirësish për lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara dhe në mënyrë të veçantë të personave që, për çfarëdolloj arsyeje, kanë një aftësi lëvizëse të kufizuar të përhershme ose të përkohshme;

b) pengesat që kufizojnë ose pengojnë personat në përdorimin komod dhe të sigurt të hapësirave dhe pajisjeve të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale;

c) mungesat e mjeteve dhe sinjalizimeve që lejojnë orientimin apo njohjen e vendeve dhe të burimeve të rrezikut nga personat me aftësi të kufizuara dhe, në veçanti, për personat me shikim apo dëgjim të kufizuar.

3. **“Personat me aftësi të kufizuara”**, personat me kufizim të aftësive në lëvizje, si pasojë e dëmtimeve afatgjata fizike, mendore, intelektuale apo shqisore dhe personat me shikim apo dëgjim të kufizuar të cilët në ndërveprim me pengesa të ndryshme pengohen në pjesëmarrjen e tyre efektive në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, në pozita të barabarta me të tjerët.



KREU II

RREGULLAT DHE KRITERET PËR
KUSHTET TEKNIKE QË DUHET TË
PLOTËSOJË INSTITUCIONI I
EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE

Neni 5

**Ndërtesat e institucionit të ekzekutimit të
vendimeve penale**

Institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale përmbush elementet e mëposhtme:

a) ndërtesat kanë një ndarje të qartë të hapësirave të ndryshme funksionale për arsye të brendshme sigurie dhe teknike. Ndërtesat ose pjesët e ndërtesave projektohen dhe strukturoren duke shmangur hapësirat për të cilat nuk mundësohet pamje e plotë;

b) muri rrethues ndërtohet me shtresë betoni, të përforcuar me skarë hekuri;

c) fasadat e mureve dhe ndërtesave ndërtohen me material të rrëshqitshëm;

ç) çatia mbulohet me një shtresë betoni shtesë, të përforcuar me hekur;

d) pozicionimi i vendosjes së mjediseve të fjetjes së të burgosurve shmang shikimin e drejtpërdrejtë nga dritaret e mjediseve të administratës së institucionit dhe të ndërtesave përreth;

dh) pozicionimi i dritareve dhe mjediseve të ajrimit duhet të shmangë përpjekjet e të burgosurve për t'u ngjitur në fasadat e ndërtesës;

e) kanalet pajisen me vida sigurie ose bllokime të çdo lloji tjetër dhe nuk duhet të shërbejnë si rrugë arratisjeje apo për futjen dhe nxjerrjen e sendeve të ndryshme.

Neni 6

Hapësira e jashtme

1. Jashtë ndërtesave të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale krijohen hapësira me të cilat lidhet ndërtesa e mjediseve të fjetjes. Hapësira e jashtme e institucionit nuk është e vrotueshme nga shikimi i qytetarëve dhe e anasjella.

2. Hapësira e jashtme vendoset në afërsi të mjediseve të fjetjes të të burgosurve.

3. Në hapësirat e jashtme improvizohen ambiente sportive funksionale dhe lehtësisht të kontrollueshme nga personeli i sigurisë.

Neni 7

Kriteret teknike të ndërtesës

1. Ndërtesat e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale përmbushin të gjitha kriteret e përcaktuara në shtojcën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, si dhe legjislacionin në fuqi për kërkesat minimale të performancës së energjisë së ndërtesave dhe elementeve të tyre.

2. Veshjet me xhama vertikale dhe horizontale, të cilat janë të ekspozuara ndaj diellit, kombinohen me një mbrojtje të jashtme ndaj diellit. Me qëllim reduktimin struktural ndaj mbingrohjes vendoset një mbrojtje e jashtme fleksibël kundër diellit.

3. Për përthithjen e zhurmave të komponentëve të jashtëm dhe për zgjatjen ekuivalente të reduktimit të saj përdoren materiale të cilat mundësojnë eliminimin e zhurmave dhe temperaturave.

4. Dyshemetë shtrohen me pllaka me material *grez-porcelanat*. Në zona të veçanta, dyshemeja shtrohet me beton të lëmuar.

Neni 8

**Elementet teknike dhe funksionale të
regjimit të jashtëm**

1. Elementet teknike dhe funksionale të regjimit të jashtëm janë, si më poshtë vijon:

a) muri rrethues është i ndërtuar me përforcime betoni me hekur, i pakalueshëm në mënyrë direkte, është me lartësi 5 - 6 m dhe me gjerësi 1 metër e cila në pjesën e sipërme mundëson kalimin dhe lëvizjen e punonjësve të Policisë së Burgjeve;

b) hapësira jashtë murit rrethues është me distancë 5 m;

c) rrethimi perimetrik i pajisur me rrjetë teli me gjemba i vendosur në brendësi dhe paralel me murin rrethues me lartësi 4.5 m.

2. Rrjeta e telit me gjemba ndërtohet me kthesa të vogla, që mundëson shikimin dhe është i kontrollueshëm me vendosjen e detektorëve të lëvizjes. Hapësira ndërmjet murit rrethues dhe rrethimit perimetrik është sa më e vogël e mundshme për të mundësuar kalimin për qëllime mirëmbajtjeje.

3. Në murin rrethues vendosen vendshërbimet për punonjësit e Policisë së Burgjeve me lartësi deri në 2.4 – 2.6 metra nga pjesa e sipërme e murit, të



mbrojtura me vetrata me xham antiplumb. Vendshërbimi siguron shikueshmëri në 360°.

4. Porta hyrëse në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale ndahet në dy pjesë të ndara nga njëra-tjetra ku një pjesë shërben për hyrjen dhe daljen e personave dhe një pjesë për hyrjen ose daljen e automjeteve.

Neni 9

Ndarja e mjediseve

1. Ndarja e mjediseve të institucionit, emërtimi dhe vlerësimi që zë secili prej tyre janë sipas shtojcës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ndërtesat e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale ndërtohen të ndara nga pjesa e jashtme me një distancë të paktën 10 metra nga muri perimetrik.

Neni 10

Regjimi i brendshëm

1. Mjediset e fjetjes lidhen mes tyre me korridore të përbashkëta. Korridoret kanë hapësira të mjaftueshme për lëvizjen drejt mjediseve të tjera të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale. Gjerësia e korridoreve është jo më pak se 2.6 metra.

2. Muret e mjediseve të fjetjes ndërtohen me material betoni dhe hekuri.

3. Hapësira e brendshme e mjediseve të fjetjes është në çdo rast jo më pak se 9 m³ (metër kub).

4. Për sa është e mundur, shmanget vendosja e dritareve në pjesën veriore të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale. Hapësira e dritareve është jo më pak se 160x150 centimetra dhe pajiset me xham antivandalë. Elementet e dritares janë të paçmontueshme.

5. Dyert e mjediseve të fjetjes janë prej materiali hekuri me çelësa të posaçëm sigurie dhe skarë hekuri. Dyert janë të blinduara dhe pajisen me dritare të vogël me xham antivandalë, me përmasa 22x26 centimetra, si dhe një hapje tjetër me përmasa të njëjta për kalimin e ushqimit.

6. Skarat metalike të dritareve dhe dyerve janë me hekur/çelik, me diametër jo më të vogël se 22 milimetra, kombinuar me shirita metalikë me profil jo më të vogël se 12x12 milimetra.

7. Institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale pajiset me ashensor i cili përshkruan të gjitha katet e ndërtesës. Ashensori ka përmasa për lëvizjen e 8 (tetë) personave dhe mundëson mbajtjen e barelës së shërbimeve shëndetësore.

Neni 11

Mjediset e fjetjes

1. Mjediset e fjetjes pajisen me tualet të ndarë nga mjediset e tjera të qëndrimit. Dera e tualetit vendoset në pozicion të tillë që të mos pengojë pamjen e brendshme të mjedisit të fjetjes kur kontrollohet nga punonjësit e Policisë së Burgjeve.

2. Ndriçuesit në mjediset e fjetjes janë inkandeshentë dhe antivandalë. Mjedisi pajiset me rrjet të përshtatshëm prizash dhe spinash.

3. Në varësi të kapacitetit të institucionit të sigurisë së lartë, një numër i caktuar mjedisesh fjetjeje përshtaten për zbatimin e regjimit të posaçëm sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve dhe rregulloren e përgjithshme të burgjeve.

Neni 12

Shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe ekzaminimet

1. Shërbimi shëndetësor ofrohet në një mjedis të përshtatshëm brenda institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale për të mundësuar ofrimin sa më të shpejtë të tij.

2. Mjediset, standardet dhe mjetet e shërbimeve shëndetësore në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale përcaktohen në shtojcën nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale krijohen edhe mjedise të posaçme për kryerjen e ekzaminimeve dhe konsultave. Këto mjedise aksesohen nga të burgosurit në rrugë të ndryshme nga kalimi për në mjediset e fjetjes.

4. Dhomat e konsultës pajisen me EDP.

Neni 13

Mjediset për aktivitete fizike e sportive

1. Mjediset për aktivitete fizike e sportive vendosen në ambiente të mbyllura. Dyshemeja e



këtyre mjediseve është elastike dhe kur është e nevojshme mundëson instalimin e pajisjeve të ndryshme sportive.

2. Mjediset për aktivitete fizike e sportive kanë 1 (një) hyrje dhe dalje shtesë.

Neni 14

Mjediset e qëndrimit dhe veprimtarive të përbashkëta

Në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale krijohet një mjedis i mbyllur i përbashkët qëndrimi dhe për kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të riteve fetare, zhvillimin e mbledhjeve, si dhe kryerjen e veprimtarive të tjera të lejuara.

Neni 15

Mjediset për kryerjen e vizitave

1. Mjediset për kryerjen e vizitave janë të ndara nga mjediset e fjetjes dhe nuk lejojnë kalimin e vizitorëve në mjediset e fjetjes dhe as kalimin e të burgosurve nga dhoma e vizitave në ambientet e jashtme.

2. Korridoret e kalimit të vizitorëve janë gjithashtu të ndara nga korridoret e kalimit të të burgosurve në mjediset e fjetjes.

3. Mjediset e posaçme për kryerjen e vizitave janë në afërsi të hyrje-daljes së institucionit. Në hyrje instalohen detektorë metali dhe krijohen dhomat e kontrollit me qëllim ndalimin e futjes së sendeve të ndaluara në institucion.

4. Ndarja ndërmjet vizitorëve dhe të burgosurve në mjedisin e posaçëm për kryerjen e vizitave bëhet me xham dhe komunikimi realizohet me anë të pajisjeve telefonike të instaluar nga të dyja anët.

5. Pajisjet telefonike vendosen në raport me kapacitetin e institucionit, por, në çdo rast, jo më pak se 8 (tetë) poste telefonike. Kabllot lidhës vendosen brenda tubave metalikë.

6. Mjediset e takimeve speciale ndërtohen sipas kritereve të mjediseve të fjetjes.

Neni 16

Mjediset e punës

1. Mjediset e punës në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale krijohen, për aq

sa është e mundur, në ndërtesa të ndara nga ndërtesat ku ndodhen mjediset e fjetjes.

2. Kushtet dhe kriteret për krijimin e mjediseve të punës përshtaten sipas kërkesave të llojit të punës dhe parashikimeve të legjislacionit në fuqi që rregullon marrëdhëniet e punës.

3. Mjedisi i punës pajiset me instalime elektrike të mjaftueshme për të mundësuar lidhjen e pajisjeve të punës.

4. Në mjedisin e punës krijohet një hapësirë e posaçme për magazinimin e materialeve dhe mjeteve të punës.

5. Në hyrje dhe dalje vendosen detektorë metali me qëllim kontrollin e të burgosurve.

Neni 17

Kuzhina dhe mjedisi i ngrënies

1. Mjedisi i ngrënies së institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale vendoset në afërsi të mjediseve të fjetjes, duke krijuar lidhje të drejtpërdrejta me korridor.

2. Mjedisi i ngrënies lidhet, gjithashtu, drejtpërdrejt me kuzhinën, në të cilën ka akses vetëm personeli i institucionit dhe të burgosurit të punësuar në kuzhinë.

3. Kuzhina ka hapësirë të mjaftueshme për të vendosur pajisjet e kuzhinës dhe të ngrënies, si dhe produktet ushqimore, në raport me kapacitetet e institucionit.

Neni 18

Mjediset e administratës

Mjediset e administratës së institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale vendosen pranë hyrje-daljes së institucionit. Hapësirat e këtyre mjediseve krijohen duke mbajtur në konsideratë kapacitetin e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, numrin e punonjësve dhe veprimtaritë e tyre.

Neni 19

Mjediset e furnizimit dhe mjediset ekonomike

Mjediset e furnizimit dhe mjediset ekonomike aksesohen nga hyrja kryesore e institucionit. Hapësirat e sheshit dhe të rrugëve të kalimit duhet të jenë të tilla që të marrin parasysh mundësinë e



lëvizjes së automjeteve me përmasa të mëdha. Sipërfaqja e shesheve dhe rrugëve të kalimit është e shtruar me asfalt.

KREU III VLERAT E IDENTIFIKIMIT FIZIK

Neni 20

Kriteret për reduktimin e zhurmave

1. Muret e mjediseve të institucionit të ekzekutimeve penale, veçanërisht mjediset e përbashkëta të kohës së lirë, vishen me shtresa të posaçme për reduktimin e zhurmave dhe përmirësimin e akustikës. Veshja me shtresa e këtyre ambienteve bëhet e tillë që rikthimi i zërit dhe niveli i reduktimit të zhurmës të arrijnë maksimumin e lejueshëm.

2. Në zonat e lëvizjes mund të jetë një shtresë më pak ose të përdoren panele me karton, në mënyrë që të arrihet mjaftueshëm ulja e nivelit të zhurmës. Gjithashtu, mund të krijohen zonat e nevojshme për përthithjen e zhurmës. Koha e llogaritur nuk duhet t'i kalojë 1.5 sekonda.

3. Në mjediset, ku zhvillohen klasa mësimore, koha e kthimit të zërit është 0.7 sipas frekuencës së mesme prej 500 Hz 0.9 sekondash.

4. Mjediset e aktiviteteve fizike dhe sportive përfshijnë masa për reduktimin e nivelit të zhurmës nëpërmjet veshjes së mureve me shtresa.

Neni 21

Pajisjet teknike dhe elektrike

1. Furnizimi i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale me energji elektrike bëhet me anë të një rrjeti kryesor me një linjë furnizimi 20 kw dhe një burimi dytësor. Me qëllim sigurimin me energji elektrike në situata të veçanta, instalohet edhe një transformator dhe gjenerator rezervë.

2. Në rastin e mungesës së energjisë elektrike nga linja kryesore vendoset gjeneratori i emergjencës për mbajtjen në punë të pajisjeve më të nevojshme në objekt dhe merret parasysh një rezervë prej 50%.

3. Pajisjet për sigurinë në institucion lidhen në çdo rast edhe me rrjetin e furnizimit në rastet e emergjencës, veçanërisht serverat, për pajisjet e alarmit dhe të videokamerave, sistemet e hyrjes dhe të daljes etj.

Faqe| 8554

4. Instalimet që kryhen në objekt bëhen duke i futur në brendësi të murit në mënyrë që të mos lejohen manipulimet.

5. Për të siguruar lehtësi në përdorimin dhe menaxhimin e mëvonshëm të këtyre sistemeve bëhen shënime dhe lihen gjurmë në rrugët e shtrimit dhe instalimit, në mënyrë që të jenë të evidentueshme kur të kryhen punime ose riparime të defekteve.

6. Pajisjet e ndriçimit vendosen sipas standardeve ndërkombëtare. Sipas përkatësisë dhe destinacionit të mjedisit, duhet të aplikohen vlerat e ndriçimit sipas shtojcës nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7. Në ndërtesa instalohet rrjeti i tokëzimit dhe mbrojtjes nga rrufetë.

8. Ndërtesa pajiset me një pajisje automatike për të treguar zonën e zjarrit.

9. Për mjediset e fjetjes, zonat e lëvizjes në ajër të pastër (sheshet e ajrimit) dhe zona të tjera të përgjithshme vendoset një pajisje fonie me anë të së cilës mund të komunikohet nga çdo zyrë e administratës së institucionit që ka si detyrë komunikimin me të burgosurit.

10. Me qëllim lidhjen me sinjale radioje dhe televizive, vendosen antena qendrore me anë të të cilave dërgohen sinjale në mjediset e fjetjes dhe në mjediset e tjera ku është e nevojshme, si dhe vendoset një pajisje satelitore nëpërmjet së cilës të merren edhe stacionet digjitale të radios dhe televizionit në mënyrë qendrore.

11. Për realizimin e rrjetit të IT-së për postet e punës individuale, kabloja është “kablo rrjeti informatik kategoria e 7-të” (UTP ose CTP). Nëpërmjet ngjyrave përcaktohet priza e fuqisë dhe priza e UP, modul telefoni dhe modul interneti.

12. Furnizimi i pajisjeve teknologjike të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale dhe pajisjet e dispozimit disenjohen në mënyrë të sigurt dhe ekonomike, duke mbajtur parasysh parametrat e paraqitur në shtojcën nr. 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 22

Instalimet e sistemit të ngrohjes dhe ventilimit

1. Sistemi i ngrohjes së institucionit të ekzekutimit të vendimit penal realizohet me



ngrohje qendrore me kaldajë me gaz, me naftë dhe me panele diellore në kombinim dhe me pompa nxehtësie.

2. Sistemi i tubacioneve izolohet në mënyrë të plotë dhe shpërndarja e tyre në zona të dukshme mbulohet me veshje alumini.

3. Ventilimi është i ndarë nga sistemi i ngrohjes. Ventilatorët shoqërohen me absorbues zhurme dhe kontrollues për volumin e ventilimit.

4. Në instalimet e rrjetit të ujit vendosen pajisje për përpunimin e tij.

Neni 23

Rrjeti kompjuterik dhe serverat

1. Rrjeti kompjuterik përdoret nga rrjeti telefonik i brendshëm IP, sistemi i kamerave IP, kompjuterat dhe printerat e rrjetit.

2. Kabllot dhe fibra optike për ndërtimin e rrjetit bëhen sipas standardeve të shtresave të rrjetit *access layer, distribution layer, core layer*.

3. Pajisjet lidhëse të rrjetit *switch* dhe *router* kanë specifikat sipas shtresës së rrjetit ku ato përdoren.

4. Sasia dhe shpërndarja e rrjetit kompjuterik në zyra bëhet sipas numrit të punonjësve.

5. Materialet që përdoren për ndërtimin e rrjetit janë kabllot *Ethernet Cat 5e*, fibër optike *patch panel, patch cord, patch* guidë, *rack* për rrjetin etj.

6. Kabllot e furnizimit me energji janë rezistente kundër zjarrit.

7. Serverat përdoren për ngritjen e *domain controller*, sistemit të kartelave të të dënuarve dhe sistemin antivirus.

8. Kapacitetet dhe specifikimet teknike të serverave janë jo më të vjetra se një 1 (vit) nga data e instalimit dhe e vënies në eficiencë të këtyre pajisjeve.

KREU IV

RREGULLAT DHE KRITERET PËR KUSHTET E SIGURISË QË DUHET TË PLOTËSOJNË INSTITUCIONET E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE

Neni 24

Siguria e jashtme e institucionit

1. Siguria e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale garantohet nga punonjësit e Policisë së Burgjeve.

2. Hapësira e jashtme e institucionit komandohet nga punonjësit e Policisë së Burgjeve, e konsideruar si zona e sigurisë. Madhësia e zonës së sigurisë varet nga madhësia e institucionit dhe niveli i tij i sigurisë. Kjo zonë vendoset si një njësi strukturore e pavarur nga ndërtesat e tjera ose si njësi e posaçme e tyre.

3. Punonjësit e Policisë së Burgjeve garantojnë sigurinë në institucion edhe nëpërmjet vendrojave. Kabina e punonjësit të Policisë së Burgjeve në portën hyrëse të institucionit pozicionohet në mënyrë që të ketë shikueshmëri të qartë të murit të jashtëm rrethues dhe pjesës së brendshme të institucionit. Për lehtësi të kontrollit, punonjësi i Policisë së Burgjeve ka akses shikimi në monitor për kamerat e jashtme të institucionit. Dritaret e kabinës së punonjësit të Policisë së Burgjeve janë të pajisura me veshje antiplumb dhe, nëse është e nevojshme, ka mbështjellje me skara hekuri.

4. Madhësia e kabinave është e përshtatshme për qëndrimin e punonjësit të Policisë së Burgjeve dhe vendosjen e monitorëve.

5. Dhomat e zhveshjes për personelin janë në afërsi të hyrje-daljes së institucionit.

Neni 25

Monitorimi i institucionit

1. Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, me përjashtim të mjediseve të fjetjes, tualeteve, ambienteve ku ofrohen shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe ekzaminimet, si dhe ambienteve të punës së administratës, mbikëqyren me videokamera. Të gjitha kamerat kryejnë regjistrime në formë digjitale dhe kontrollohen nga qendrat e kontrollit me monitor.

2. Në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale krijohet dhoma e serverave ku instalohen pajisjet kryesore të menaxhimit të të gjitha sistemeve të sigurisë e të teknologjisë së informacionit të institucionit.

3. Për arsye sigurie dhoma e serverave ndërtohet në mjediset e ndërtesës së administratës së institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale. Dhoma e serverave vendoset jashtë regjimit të brendshëm dhe është e paaksesueshme nga të burgosurit.

4. Standardet e ndërtimit të dhomës së serverave janë sipas rregullave të përcaktuara nga institucioni



përgjegjës për kontrollin e shoqërisë së informacionit.

Neni 26

Kushtet e sigurisë nga zjarri

1. Në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale sigurohen mjete të përshtatshme dhe masa për mbrojtjen nga zjarri, nëpërmjet instalimit të alarmit të detektorëve të zjarrit dhe një linje fikse të thatë me hidrantë muri për gradët korrespondues të zjarrit.

2. Institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale në ambientet e brendshme pajiset me kaseta hidranti për mbrojtjen nga zjarri.

3. Ndërtesat e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale pajisen gjithashtu me rrufepritëse.

4. Monitorimi i sistemit të detektorëve të zjarrit bëhet nga operatorët në sallën e monitorimit.

5. Projekti për mbrojtjen nga zjarri përmban instalimin e plotë të rrjetit të mbrojtjes nga zjarri me hidrantë uji brenda dhe jashtë, si dhe pajisjen e objektit me mjete për shuarjen e zjarrit, si fikës zjarri të instaluar në mure dhe kaseta me mjete të tjera për shuarjen e tij.

Neni 27

Siguria e të burgosurve në institucion

1. Siguria e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale bëhet sipas kriterëve të caktuar në nenin 8, të këtij vendimi.

2. Pajisjet teknologjike të sigurisë shërbejnë për të parandaluar arratisjen e të burgosurve ose ndalimin e personave që hyjnë në mbështetje të të burgosurve.

3. Pajisjet garantojnë mbrojtjen e punonjësve të Policisë së Burgjeve, nëpërmjet zbulimit, sa më shpejt që të jetë e mundur, të sulmeve që mund të ndërmarrin të burgosurit mbi ta ose ndaj të burgosurve të tjerë.

4. Për të mundur një mbikëqyrje sa më mirë të ambienteve brenda dhe jashtë ndërtesave, instalohen pajisje të përshtatshme ndriçimi, të cilat shërbejnë për të kryer aktivitetin e përgjithshëm dhe aktivitetet në hapësirat e lëvizjes së jashtme. Ndriçuesit vendosen në lartësinë e duhur dhe me ndriçimin e duhur për të mundur qartësi shikimi.

5. Për ndriçimin e hapësirave të oborreve të brendshme vendosen shtylla me disa pika ndriçimi.

6. Në fasadat e jashtme të ndërtesave instalohen drita me fuqi të ulët, të cilat mundësojnë mbikëqyrjen me kamera. Këto drita vendosen në mënyrë të tillë që të sigurohet një qartësi sa më e mirë për kamerat dhe monitorët e videokamerave.

7. Për të sinjalizuar lëvizjen dhe lokalizimin e personave, si shtesë e ndriçimit të zakonshëm dhe ndriçimit të jashtëm përdoren dritat e alarmit me halogjen.

8. Hapësira nga muri perimetrik deri të muret e ndërtesave mbikëqyret nëpërmjet detektimit të lëvizjes me anë të vlerësimit të figurës me videodiferencim.

9. Fasadat e ndërtesës së burgimit vëzhgohen nga videokamera, të cilat janë të montuara dhe të rregulluara me lëvizje në mënyrë të shpejtë dhe që tregojnë objekte veçanërisht intensive.

10. Hapësirat jashtë murit të sigurisë mbikëqyren nëpërmjet një fijezim automatik që sinjalizon lëvizjet.

11. Zonat e brendshme bllokohen me dyer që mbyllen me kyçe të automatizuara.

Neni 28

Kriteret teknike të sistemeve të sigurisë

1. Kamerat e jashtme të rrotullueshme kontrollojnë gjithë territorin e burgjeve, janë I.P. kamera, antivandale, ditë-natë, WDR, min 2 Mp, dhe punojnë në kushtet ekstreme të mjedisit.

2. Kamerat mbulojnë të gjithë ambientin e jashtëm dhe të brendshëm ku kryhen aktivitete gjatë veprimtarisë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

3. Softi i regjistrimit është i sigurisë së lartë me certifikatë për mospërpunim figure. Koha e regjistrimit është minimumi 3 (tre) muaj.

4. Salla e monitorimit krijohet në varësi të kapacitetit të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, por, në çdo rast, jo më pak se 8 monitorë 52".

5. Sistemi ka pavarësi nga rrjeti për të paktën 12 orë.

6. Pajisjet e regjistrimit janë në një rack.

7. Telefonia e brendshme është I.P. Telefoni është i përshtatshëm për përdorim në minimum nga 200 numra.



8. Sistemi i telefonisë I.P. integrohet me sistemet e rrjetit kompjuterik dhe atë të kamerave në institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale.

Neni 29

Pajisjet bllokuese

1. Në të gjithë hapësirën e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale instalohen aparatura dhe pajisje për bllokimin e të gjitha komunikimeve telefonike nëpërmjet çfarëdolloj aparati celular dhe satelitor.

2. Pajisjet bllokuese punojnë në mënyrë të pandërprerë. Pajisjet janë me ushqim 220 V AC dhe ushqim 12 ose 24 v DC. Ato janë pajisura me bateri të brendshme dhe aksesoret përkatës për të siguruar një vazhdimësi në punë për një interval kohor prej minimumi 6 orë në rastet e ndërprerjes së energjisë elektrike nga rrjeti i furnizimit të burgut.

3. Pajisjet bllokuese nuk interferojnë ose ndikojnë në punën e pajisjeve dhe aparaturave të sistemit të komunikimit RF, të sistemit të monitorimit me kamera dhe rrjetit të kompjuterave apo në punën normale të aparaturave elektromjekësore të instaluar në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale.

4. Pajisjet bllokuese nuk interferojnë ose bllokojnë komunikimet telefonike celulare dhe RF në objektet shtetërore dhe banesat civile, të cilat mund të jenë pranë territorit të burgjeve.

5. Pajisjet bllokuese dhe antenat rrezatuese instalohen në vende që lejojnë kryerjen e funksionit optimal të tyre dhe nuk dëmtojnë me rrezatime RF personelin e shërbimeve, punonjësit dhe personat që kryejnë dënimin në burg.

Neni 30

Sistemi i mbrojtjes perimetrike

Në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale instalohet:

a) sistem alarmi me sensor, i shtrirë në gardhin rrethues për të zbuluar çdo kontakt të mundshëm;

b) sistem me sensor të shtrirë në tokë për lëvizjet sizmike për të zbuluar lëvizjet dhe kanalet nëntokësore;

c) sistem *shock* i vendosur mbi gardhin e murit perimetrik;

ç) sistemi me infra për lartësitë.

Neni 31

Sistemi i komunikimit me radio

1. Sistemi i komunikimit me radio për punonjësit e Policisë së Burgjeve krijohet nëpërmjet një *trunk*-u digjital *multisite* me 4 kanale.

2. Të gjitha shërbimet kanë radiostacione dhe çdo punonjës pajiset me radio dore.

3. Radiot e dorës kanë GPS të inkorporuar:

a) me *software* me hartën digjitale të Shqipërisë dhe për GPS dhe DATA;

b) me *software* për *Multi Site Trunk Network*;

c) me *software FleetSync AVL & Dispatch Messaging Software*, (AVL – *Automatic Vehicle location*);

ç) sistemin e telefonisë I.P.

KREU V

RREGULLAT DHE KRITERET PËR PËRSHTATSHMËRINË DHE AKSESUESHMËRINË E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR

Neni 32

Ndërtesat e institucioneve

1. Të burgosurve me aftësi të kufizuara u garantohen të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, trajtimi pa diskriminim i çdo forme për shkak të aftësisë së kufizuar, duke plotësuar nevojat specifike për aftësimin dhe riaftësimin e tyre, duke mbajtur parasysh standardet e legjislacionit në fuqi për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara.

2. Në raport me kapacitetin e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, një numër i caktuar mjedisesh fjetjeje përshtaten për të burgosurit me aftësi të kufizuar, si dhe krijohen lehtësi për aksesimin dhe përshtatshmërinë e tyre gjatë ekzekutimit të vendimeve penale.

3. Për të burgosurit me probleme të shëndetit mendor, për të cilët gjykata ka vendosur zbatimin e masave mjekësore të detyrueshme, ndërtesat e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale janë të posaçme, me qëllim akomodimin e kësaj kategorie të burgosurish, në përputhje me legjislacionin në fuqi për shëndetin mendor.

4. Gjatë projektimit dhe ndërtimit të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale apo rikonstruktimit të tyre, sipas legjislacionit në fuqi, aplikohen zgjidhje teknike për eliminimin e



barrierave penguese për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim mosdiskriminimin dhe sigurimin e lëvizjes pa pengesa dhe qëndrim të barabartë në këto ambiente me personat e tjerë.

5. Ndërtesat e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale duhet të plotësojnë elemente teknike për të mundësuar aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar në të gjitha ambientet e ndërtesës dhe për të përdorur të gjitha shërbimet që ofron institucioni, duke mbajtur në konsideratë përdorimin e krevateve, vendeve ulëse, shkallëve, shërbimet e higjienës, aksesin në vendin e ngrënies, aksesin në ambientet e takimeve, në ambientet e ajrimit si dhe çdo ambient tjetër pune, argëtimi apo mësimi.

6. Ndërtesat e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale duhet të plotësojnë elementet e mëposhtme:

a) dyert e hyrjes së çdo ndërtese janë lehtësisht të manovrueshme, ku lloji dhe hapësirat e tyre lejojnë kalimin me lehtësi të personave me aftësi të kufizuara;

b) pragu i derës, përpara dhe pas saj, vendoset në të njëjtën nivel me sipërfaqet e ambienteve. Ndryshimi i nivelit lidhur me madhësinë e derës së hyrjes të një ndërtese ose në ndërhyrjet në rikonstrukcion nuk duhet të pengojë kalimin e një personi me aftësi të kufizuara;

c) përmasat e hapësirës para dhe pas derës lejojnë manovrat që kryhen me karrige me rrota. Hapësira duhet të mundësojë hapjen e derës nga të dyja anët e përdorimit;

ç) në ambientet e përbashkëta dyshemetë janë të sheshta dhe jorrëshqitëse;

d) ndryshimet e nivelit kapërcehen nëpërmjet platformave të pjerrëta, të përshtatura në mënyrë të tillë që të mos krijojnë pengesa për kalimin e personave me aftësi të kufizuara;

dh) pajisjet e palëvizshme në njësitë e ambientit duhet të vendosen në mënyrë të tillë që të lejojnë kalimin e personave me aftësi të kufizuara si dhe përdorimin me lehtësi të karrocave me rrota ose mjeteve ndihmëse. Duhet t'u jepet përparësi përdorimit të pajisjeve me material joprerës dhe pa kënde të mprehta;

e) në shkallët e ndërtesës montohen edhe kangjella mbajtëse për të lehtësuar përdorimin e shkallëve nga personat që kanë vështirësi në lëvizje;

ë) shërbimet higjienike duhet të garantojnë, nëpërmjet hapësirave të llogaritura, manovrimet e

nevojshme të një karrigeje me rrota, për përdorimin e pajisjeve sanitare, në veçanti:

i. hapësira e nevojshme për afrimin anësor të karriges me rrota te WC-ja, bideja, dushi;

ii. hapësira e nevojshme për afrimin ballor të karriges me rrota te lavamani;

iii. vendosja e një mbajtëseje të përshtatshme dhe e një zileje emergjence e vendosur afër WC-së dhe dushi;

f) gjerësia e rampave të pjerrëta dhe e sheshpushimeve duhet të lejojë kalimin në të njëjtën kohë të dy personave ose kalimin horizontal të një barele, me një pjerrësi maksimumi 15% përgjatë boshtit gjatësor;

g) gjatësia e rampës së pjerrët duhet të jetë e kufizuar, në të kundërt ajo duhet të ndërpritet me një sheshpushim. Rampat e shkallëve duhet të jenë lehtësisht të perceptueshme edhe nga personat me kufizime në shikim dhe dëgjim.

Neni 33

Sinjalistika

1. Në ambientet e institucionit vendoset një sistem shenjash që tregojnë aktivitetet kryesore që zhvillohen dhe rrugët e nevojshme për t'i arritur.

2. Për të burgosurit me vështirësi në shikim vendosen pajisje zanore për treguesit e dhënë ose tabela qendrore të shkruara me alfabetin *braille*. Çdo situatë rreziku duhet të jetë e dallueshme edhe nëpërmjet shenjave sinjalizuese dhe mjeteve referuese, si ato zanore ashtu edhe pamore.

3. Institucionet pajisen me lajmërues akustik, që sinjalizon kohën e ajrimit, për personat me kufizime në shikim dhe dëgjim, aty ku është e nevojshme me komanda manuale të arritshme për të lejuar kohën e mjaftueshme për ajrim në mjedise të hapura.

4. Tabelat dhe pajisjet sinjalizuese të shërbimeve në institucion pajisen dhe instalohen në pozicion të tillë që të shihen dhe të lexohen lehtësisht.

5. Zyrat, kabinat telefonike ose pajisjet, si ashensorët dhe telefonat, që sigurojnë shërbime komunikimi për personat me aftësi të kufizuar dëgjimi, duhet të kenë në pozicion të dukshëm simbolin ndërkombëtar të hyrjes për këta persona.

6. Në rastin e ndryshimit të nivelit të dyshemeve vendoset sinjalizim i dallueshëm me ngjyra me nuanca të forta ose të shndritshme me qëllim



lehtësimin e lëvizshmërisë për personat që kanë vështirësi në shikim.

Neni 34

Vendosja e pajisjeve

1. Në raport me kapacitetin e institucionit, një numër i caktuar telefonash vendosen në lartësi prej 120 centimetra nga sipërfaqja e dyshemesë që receptori të mund të kapet me dorë në lartësi prej 100 centimetra.

2. Instalimet elektrike duhet të kenë:

a) interfon të vendosur në lartësi deri 120 centimetra nga dyshemeja me indikacione drite;

b) ndërprerës të dritës dhe ziles, i vendosur në lartësi prej 90 deri 120 centimetra nga dyshemeja;

c) prizat në kuzhinë të vendosura mbi sipërfaqen e punës;

ç) prizat e tjera të vendosura në lartësi prej 90 deri 120 centimetra nga dyshemeja;

d) kuadër elektrik, vendosur në lartësi prej 90 deri 120 centimetra;

dh) të gjitha pajisjet e instalimeve elektrike të kenë ngjyrë në kontrast me sipërfaqen ku montohen.

Neni 35

Shmangia e reziqeve

Tabelat, pajisjet sinjalizuese, strukturat mbajtëse të linjave elektrike, telefonike, instalimet e ndriçimit

dhe pajisjet e çfarëdolloj tipi instalohen në mënyrë të tillë që të mos bëhen burim aksidentesh ose pengesash për personat me aftësi të kufizuara.

Neni 36

Kriteret teknike të ndërtesave

Në projektimin, ndërtimin apo rikonstrukcionin e ndërtesave të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, përveç rregullave të përmendura në këtë vendim, respektohen të gjitha parashikimet e legjislacionit të brendshëm mbi përcaktimin e rregullave për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara.

KREU VI

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 37

Rregulla të fundit

1. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve bën përmirësimin periodik të standardeve.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Arben Ahmetaj

SHTOJCA 1

Vlerat e identifikimit fizik

Komponentët	Tipi	Mbrojtja e ngrohjes	Mbrojtja e zhurmës së ajrit	Mbrojtja e zhurmës së goditjes
		U [$\text{J}/\text{m}^2 \text{ K}$]	R_e or D_n /të [dB]	L_n /të [dB]
Muret e jashtme	AË	$\frac{<<hp1\ 5=0>}{0.50</hp1\ 5=0>}$	≥ 47	-
Muret e jashtme në tokë	AË	$\frac{<<hp1\ 5=0>}{0.50</hp1\ 5=0>}$	-	-
Çatia e rrafshët	AË	$\frac{<<hp1\ 5=0>}{0.20</hp1\ 5=0>}$	≥ 47	-
Kalimet	FD	$\frac{<<hp1\ 5=0>}{0.20</hp1\ 5=0>}$	≥ 47	$\frac{<<hp1\ 5=0>}{48</hp1\ 5=0>}$
Dyshemetë që prekin tokën	DU	$\frac{<<hp1\ 5=0>}{0.20</hp1\ 5=0>}$		$\frac{<<hp1\ 5=0>}{48</hp1\ 5=0>}$



Kat kundër mosngrohjes	GD	$\frac{<<hp1\ 5 = 0>}{0.40</hp1\ 5=0>}$		$\frac{<<hp1\ 5 = 0>}{48</hp1\ 5=0>}$
Ndarjet e kateve	GD	$\frac{<<hp1\ 5 = 0>}{0.90</hp1\ 5=0>}$	≥ 55	$\frac{<<hp1\ 5 = 0>}{48</hp1\ 5=0>}$
Muret e brendshme kundrejt dhomave të pangrohura	ËU	$\frac{<<hp1\ 5 = 0>}{0.70</hp1\ 5=0>}$	≥ 55 or (≥ 44)	-
Muret e brendshme	IË	$\frac{<<hp1\ 5 = 0>}{1.60</hp1\ 5=0>}$	≥ 55 or (≥ 44)	
Dyert/dritaret	F	$\frac{<<hp1\ 5 = 0>}{1.90</hp1\ 5=0>}$	-	-
Dyert e jashtme	T	$\frac{<<hp1\ 5 = 0>}{1.70</hp1\ 5=0>}$	-	-

SHTOJCA 2

SPECIFIKIMI I NDARJES SË MJEDISEVE DHE VLERËSIMI I HAPËSIRAVE PËR SECILIN PREJ TYRE

Emërtimi i funksionit	Nr. i dhomave	Persona për dhomë	Hapësira neto për dhomë	Hapësira neto për dhomë	Hapësira neto për njësi funksionale
Paraburgimi meshkuj - 80 persona					
Seksioni 1 (40 persona)					
Mjedisi i fjetjes për 1 person (lavaman+tualet+dush te tualeti)	x	1P	9.0 m ²	9*x m ²	
Mjedisi i fjetjes për 2 persona (lavaman+tualet+dush te tualeti)	x	2P	14.0 m ²	14*x m ²	
Mjedisi i fjetjes për 4 persona (lavaman+tualet+dush te tualeti)	x	4P	30.0 m ²	30*x m ²	
Banjat e përbashkëta me dush (dhe tualet)	1x		10.0 m ²	10.0 m ²	
Magazinë e vogël për seksionin	1x		15.0 m ²	15.0 m ²	
Magazinë për rroba e palara (e ventiluar)	1x		10.0 m ²	10.0 m ²	
Dhomë e mbeturinave (e ventiluar)	1x		8.0 m ²	8.0 m ²	
Mjedisi i punës (lavatrice+tharrëse) (e ventiluar)	1x		6.0 m ²	6.0 m ²	
Mjediset për aktivitetet fizike dhe sportive	1x		40.0 m ²	40.0 m ²	
Mjediset e përbashkëta me kuzhinë të vogël	1x		30.0 m ²	30.0 m ²	
Magazinë për të burgosurit+lavaman (doktori, shërbimet ndihmëse, ekzaminimi gjyqësor)	1x		20.0 m ²	20.0 m ²	
Shuma e seksionit I (40 persona)				404.0 m ²	
Shuma seksioni I (40 persona) njësoj si seksioni I				404.0 m ²	
Mjedis fjetjeje burgimi i sigurt	2x	1P		18.0 m ²	
Mjedis fjetjeje i sigurt me pajisje speciale për persona agresivë	2x	1P		18.0 m ²	
Magazinë (për të burgosurit) me ftohje – lidhje elektronike	1x			40.0 m ²	
Zyrë seksioni I-II për 3 roja+kuzhinë e vogël ndenjeje me tualet (m/f)	1x			25.0 m ²	
Nëntotali				1101.0 m²	1101.0 m²
Grupet e të dënuarve, mjediset e fjetjes për meshkuj – 20 persona					
Seksioni III (20 të burgosur)					
Mjedisi i fjetjes për 1 person (lavaman+tualet)	4 x	1P	9.0 m ²	36.0 m ²	
Mjedisi i fjetjes për 2 persona (lavaman+tualet)	4 x	2P	14.0 m ²	56.0 m ²	
Mjedisi i fjetjes për 4 persona (lavaman+tualet)	2 x	4P	30.0 m ²	60.0 m ²	
Dushe të përbashkëta (me tualet)	1 x		10.0 m ²	10.0 m ²	
Magazinë për lavanterinë (e ajrosur)	1 x		3.0 m ²	3.0 m ²	
Magazinë e vogël për departamentin	1 x		5.0 m ²	5.0 m ²	
Dhomë për mbeturinat (e ajrosur)	1 x		8.0 m ²	8.0 m ²	



Mjedis pune (lavatriçet dhe tharëset, e ajrosur)	1 x		6.0 m ²	6.0 m ²	
Mjediset për aktivitetet fizike dhe sportive	1 x		30.0 m ²	30.0 m ²	
Dhoma e kohës së lirë/kuzhinë ndenjeje/dhomë për larjen e pjatave	1 x		30.0 m ²	30.0 m ²	
Magazinë për të burgosurit+lavaman (doktori, shërbimet sociale, ekzaminimi gjyqësor)	1 x		20.0 m ²	20.0 m ²	
Shuma seksioni III (20 të burgosur)				264.0 m ²	
Zyrë sek. III për 2 roja+kuzhinë ndenjeje me tualet (m/f). Departamenti i doktorit	1x		15.0 m ²	15.0 m ²	
Nëntotali				279.0 m²	279.0 m²
Seksioni i grave (i përdorshëm edhe për minorenët) - 3 të burgosur					
Mjedisi i fjetjes për 1 person (lavaman+tualet)	1x	1P	9.0 m ²	9.0 m ²	
Mjedisi i fjetjes për 2 persona (lavaman+tualet)	1x	2P	14.0 m ²	14.0 m ²	
Dushe të përbashkëta (me tualet)	1x		10.0 m ²	10.0 m ²	
Ambiente të tjera shtesë për gra	1x	1P	10.0 m ²	10.0 m ²	
Shuma, seksioni i grave (3 të burgosura)				43.0 m ²	
Shuma, seksioni i grave				43 m²	43.0 m²
Të mitur – 7 të burgosur					
Seksioni IV (7 të burgosur; infrastruktura edhe për gratë)					
Mjedisi i fjetjes për 1 person (lavaman+tualet)	1x	1P	9.0 m ²	9.0 m ²	
Mjedisi i fjetjes për 2 persona (lavaman+tualet)	1x	2P	14.0 m ²	14.0 m ²	
Mjedisi i fjetjes për 4 persona (lavaman+tualet)	1x	4P	30.0 m ²	30.0 m ²	
Dushe të përbashkëta (me tualet)	1x		10.0 m ²	10.0 m ²	
Magazinë për lavanerinë (e ajrosur)	1x		3.0 m ²	3.0 m ²	
Magazinë e vogël për departamentin	1x		5.0 m ²	5.0 m ²	
Dhomë për mbeturinat (e ajrosur)	1x		6.0 m ²	6.0 m ²	
Zonë pune (lavatriçet dhe tharëset e ajrosur)	1x		30.0 m ²	30.0 m ²	
Dhoma e sporteve/dhomë e përbashkët për kohën e lirë	1x		30.0 m ²	30.0 m ²	
Dhoma e kohës së lirë/kuzhinë ndenjeje/dhomë për larjen e pjatave	1x		20.0 m ²	20.0 m ²	
Magazinë për të burgosurit+lavaman (doktori, shërbimet sociale, ekzaminimi gjyqësor)	1x		15 m ²	15 m ²	
Ambiente të tjera shtesë për të mitur	1x	1P	10.0 m ²	10.0 m ²	
Shuma e seksioni IV (7 të burgosur)				182 m ²	
Zyrë seksioni IV për 2 roja+kuzhinë ndenjeje me tualet (m/f)	1x		15.0 m ²	15.0 m ²	
Shuma e seksioneve				197 m²	197.0 m²



Emri i funksionit	Nr. i dhomave	Persona për dhomë	Hapësira neto për dhomë	Hapësira neto për dhomë	Hapësira neto për njësi funksionale
Hapësirë ndihmëse – Shërbimi mjekësor i Spitalit nr. 5, të burgosur					
Shërbimi i doktorit					
Zyrë për doktorin, psikiatrin, magazinë për ilaçet (me rafte), doktorët konsulentë	1x	1P	16.0 m ²	16.0 m ²	
Zyrë për dentistin + dhomë për grafitë e dhëmbëve	1x		16.0 m ²	16.0 m ²	
Dhomë mjekimi e infermiereve dhe pritjeje për të burgosurit (e ajrosur, me tualet, me dritare) meshkuj/femra	1x		16.0 m ²	16.0 m ²	
Dhomë për pacientët, secila me 2 krevate dhe me lavaman/burra (e përshtatshme edhe për handikapë)	2x	2P	14.0 m ²	28.0 m ²	
Dhomë për pacientët me 1 krevat me tualet/dush/lavaman/minorenë/meshkuj	1x	1P	9.0 m ²	9.0 m ²	
Vaskë me dush (e përshtatshme për persona handikapë)	1x		8.0 m ²	8.0 m ²	
Tualetet për të burgosurit (të ndara burrat nga gratë) dhe vaskë me dush (e përshtatshme për persona handikapë) në ambient të veçantë	1x		15.0 m ²	15.0 m ²	
Dhomë gjumi e mjekut dhe dhomë gjumi e infermierit	2x	1P	32 m ²	32 m ²	
Magazinë dhe dhomë për mbeturinat (e ajrosur)	2x		15.0 m ²	15 m ²	
Qeli për shërbimet sociale (i burgosur i punësuar) burra/gra	1x	1P	10.0 m ²	10.0 m ²	
Dhomë e promocionit dhe e psikologes	1x		15.0 m ²	15.0 m ²	
Dhoma e terapisë intensive për riaftësim fizik	1x		15.0 m ²	15.0 m ²	
Shuma, shërbimi i doktorit				195.0 m²	195.0 m²

Zyrë për shërbimet sociale në sektorin e administratës (2 persona)	1x	2P	15.0 m ²	15.0 m ²	
Shërbimi psikologjik (1 person)	1x		8.0 m ²	8.0 m ²	
Zyrë për testim dhe zyrë për hetim	1x		10.0 m ²	10.0 m ²	
Zyre e shërbimeve sociale	1x		10.0 m ²	10.0 m ²	
Shuma				43.0 m²	43.0 m²
Nëntotali, shërbimet sociale					238.0 m²

Institucionet e përgjithshme për të burgosurit					
Holl për qëllime të ndryshme për të burgosurit (aktivitete, kishë) e ndashme në dhoma të veçanta (gardërobë/sskristi dhe tualet për aktorët)	1x	40P	90.0 m ²	90.0 m ²	
Librari me zyrë	1x		40.0 m ²	40.0 m ²	
Shuma e institucioneve të përgjithshme				130.0 m²	130.0 m²

Dhoma e sporteve dhe gjimnastikës					
Emri i funksionit	Num. Dhomave	Persona për dhomë	Hapësira neto për dhomë	Hapësira neto për dhomë	Hapësira neto për njësi funksionale
Dhoma qendrore e rojave					



Zyrë për rojat, përgjegjësin dhe grupin e gatshëm, supervizioni qendror, pajisjet elektronike, rafti i çelësave dhe i armëve	1x				
Dhoma për armët speciale dhe shefin e armatimeve	1x				
Dhomë zhveshjeje për 35 roja me dush dhe tualet	1x				
Dhomë e gatshme në afërsi të dhomës qendrore të gardianëve për 3 persona me kuzhinë ndenjeje dhe dhomë për pjatat	2x	1x	150.0 m ²	150.0 m ²	
Kuzhinë ndenjeje për gatishmërinë	1x				
Dhomë pushimi për shërbimin e natës	2x				
Dhomë për mbrojtjen nga zjarri	1x				
Shuma e dhomës qendrore të rojave					
Holl i gjimnastikës (aktivitete të ndryshme)					
Shuma e dhomës së gjimnastikës				150.0 m²	150.0 m²

Zona e ekzaminimit të vizitorëve					
Zona e hyrjes					
Vendhyrja për vizitorët me pajisje elektronike, raftet e vogla me mbyllje dhe gardërobë me rreze (si në aeroporte)	1x		25.0 m ²	25.0 m ²	
Dhoma e depozitimit të bagazheve (transit për në hapësirat e mbyllura)	1x		15.0 m ²	15.0 m ²	
Zyra për rojën e derës dhe të regjistrimit të vizitorëve, hapësirë për një rojë dhe armët dhe celularët e policëve dhe avokatëve	1x		15.0 m ²	15.0 m ²	
Dhomë për kontrollin e vizitorëve	1x		5.0 m ²	5.0 m ²	
Shuma e zonës së ekzaminimit të vizitorëve				60.0 m²	60.0 m²

Vend hyrja e komandueshme nga roja i derës, më pas zona e hyrjes së mëtejshme					
a) Në zonën e hyrjes së të burgosurve (opsionale) e përdorshme edhe për autobusë					
b) Në zonën e kabanoneve të punës dhe transporti (ashensori) (opsionale) e përdorshme për kamionë të mëdhenj					

Emri i funksionit	Nr. i dhomave	Persona për dhomë	Hapësira neto për dhomë	Hapësira neto për dhomë	Hapësira neto për njësi funksionale
Zona e vizitorëve dhe e marrjes në pyetje					
Dhomë pritjeje për vizitorët me tualete (burra/gra, e përshtatshme për handikapë) 1 vend për fëmijë	1x		25.0 m ²	25.0 m ²	
Salla për shërbime sociale, shërbimet e lirimt me kusht, direkt afër zyrës së rojave	1x		15.0 m ²	15.0 m ²	
a) Dhomë për vizitorët me ndarje strikte ndërmjet vizitorëve dhe të burgosurve më 8 vende takimi (secili për 4 vizitorë)	1x		40.0 m ²	40.0 m ²	
b) Dhomë e vizitorëve për vizitat në tavolinë	1x		20.0 m ²	20.0 m ²	
Dhomë për ekzaminim gjyqësor, konferenca vizita në tavolinë (avokatë, zyrtarë të tjerë)	2x		15.0 m ²	30.0 m ²	
Zyrë për shikimin e vizitorëve dhe koordinimin, e pajisur me citofon dhe supervizion me videokamera (1 gardian)	1x		15.0 m ²	15.0 m ²	



4 dhoma pritjeje për të burgosurit, secila për 10 persona me tualet (e ajrosur, me dritare)	2x	10P	15.0 m ²	30.0 m ²	
Zonë pritjeje për vizitorët me hapësirë për fëmijët	1x		30.0 m ²	30.0 m ²	
Shuma e zonës së vizitorëve dhe e marrjes në pyetje				205.0 m²	205.0 m²

(Opsionale) Zona e marrjes në pyetje e vendosur në ballë të paraburgimit – prokuror, gjykatës					
Zona e interogimit polici/prokuror e gjykatës	2x		15.0 m ²	30.0 m ²	
Zona e interogimit për avokatët	2x		15.0 m ²	30.0 m ²	
Dhomë për masën e gjykimin (për paraburgimin/minorenët)	1x		20.0 m ²	20.0 m ²	
Dhomë pritjeje për të burgosurit, për 10 persona me tualet	1x		25.0 m ²	25.0 m ²	
Shuma e zonës së interogimit për paraburgimin/gjykata					105.0 m²

Shkolla (të rinjtë)					
Klasat	1x	7P	30.0 m ²	30.0 m ²	
Dhoma e pajisjeve të mësuesve	1x		10.0 m ²	10.0 m ²	
Tualetet/lavamanët/të burgosur m/f				10.0 m ²	
Tualetet/lavamanët/të punonjësit m/f				10.0 m ²	
Salla me mundësi për ngrënie	1x	7P	20.0 m ²	20.0 m ²	
Dhomë për pjatat mbeturinat etj.	2x		10.0 m ²	10.0 m ²	
Magazinë, pajisjet e pastrimit, mbeturinat	1x		10.0 m ²	10.0 m ²	
Shuma e shkollës				110.0 m²	110.0 m²

Emri i funksionit	Nr. i dhomave	Persona për dhomë	Hapësira neto për dhomë	Hapësira neto për dhomë	Hapësira neto për njësi funksionale
Dhomat e punës: Arte, ergoterapike, dhomat e punës motivuese					
Ergoterapia	1x	5P	25.0 m ²	25.0 m ²	
Dhomat e punës motivuese	1x	5P	20.0 m ²	20.0 m ²	
Dhomë sociale	1x		20.0 m ²	20.0 m ²	
Magazinë për punët e kryera	1x		10.0 m ²	10.0 m ²	
Zyrë për 1 person	1x		10.0 m ²	10.0 m ²	
Shuma e dhomave të punës				85.0 m²	85.0 m²

Zyra (drejtoria, komanda, administratë e ekzekutimit penal, ekonomistja)					
Drejtoria					
Zyrë e drejtorisë për mbledhje me 6 vende	1x		25.0 m ²	25.0 m ²	
Zyrë për mbledhje me kuzhinë të vogël për 25 persona	1x		50.0 m ²	50.0 m ²	
Zyrë e përfaqësuesve të drejtorisë me mundësi mbledhjeje për 4 persona	1x		20.0 m ²	40.0 m ²	
Zyrë për 2 persona	2x		15.0 m ²	15.0 m ²	
Dhoma e teknikut të kompjuterëve pranë dhomës së trajnimit për kompjuter	1x		10.0 m ²	10.0 m ²	
Magazinë për dokumente	1x		20.0 m ²	25.0 m ²	
Zyrë për 1 person	1x		15.0 m ²	15.0 m ²	
Shuma e drejtorisë				180.0 m²	180.0 m²



Komanda e rojave					
Zyra e përgjegjës të rojave për mbledhje me 4 persona	1x		20.0 m ²	20.0 m ²	
Zyra e përfaqësuesit të përgjegjës të rojave (1 person) për mbledhje për 3 persona	1x		15.0 m ²	15.0 m ²	
Zyra e punonjësve për 3 persona	1x		15.0 m ²	15.0 m ²	
Zyra e punonjësve për 3 persona	1x		15.0 m ²	15.0 m ²	
Shuma e komandës së rojës				65.0 m²	65.0 m²

Emri i funksionit	Nr. i dhomave	Persona për dhomë	Hapësira neto për dhomë	Hapësira neto për dhomë	Hapësira neto për njësi funksionale
Administrata e ekzekutimit penal					
Zyrë pritjeje (3 persona)	1x		20.0 m ²	20.0 m ²	
Zyra e administratës së ekzekutimit penal (3 persona)	1x		20.0 m ²	20.0 m ²	
Dhomë pritjeje për të burgosurit (pranim/lirim), secila për 2 persona	2x	2P	5.0 m ²	10.0 m ²	
Dhomë kontrolli për të burgosurit me dush dezinfektimi dhe tualet	1x		10.0 m ²	10.0 m ²	
Dhomë për kontroll trupor për të burgosurit, për 2 persona	1x		10.0 m ²	10.0 m ²	
Zyrë për edukim dhe kohën e lirë për mbledhje për 2 persona	1x		15.0 m ²	15.0 m ²	
Zyrë për çështje të tjera për 2 persona	1x		15.0 m ²	15.0 m ²	
Shuma – administrata e ekzekutimit penal				100.0 m²	100.0 m²
Administrata ekonomike					
Zyrë për çështje pune për 2 persona	2x		20.0 m ²	20.0 m ²	
1 dhomë e madhe për çështje financiare për 2 persona	1x		15.0 m ²	15.0 m ²	
Zyrë për administratën	1x		15.0 m ²	15.0 m ²	
Zyrë për financën	1x		15.0 m ²	15.0 m ²	
Shuma – administrata ekonomike				65.0 m²	65.0 m²
Magazinë, garazh					
Magazinë tekstilësh	1x		40.0 m ²	40.0 m ²	
Magazinë për uniforma	1x		40.0 m ²	40.0 m ²	
Magazinë për tekstilë private për të paktën 115 të burgosur me vend për sende me vlerë dhe vend për 1 person	1x		50.0 m ²	50.0 m ²	
Garazh, 1 makinë	1x		20.0 m ²	20.0 m ²	
Zyrë me lavaman (1 gardian)	1x		10.0 m ²	10.0 m ²	
Dhomë për gomaz rezervë dhe pjesët e këmbimit të makinave	1x		10.0 m ²	15.0 m ²	
Magazinë e përgjithshme E1	1x		100.0 m ²	100.0 m ²	
Dhome për servise elektro-mekanik	1x		20.0 m ²	20.0 m ²	
Shuma, magazinë, garazh				295.0 m²	295.0 m²



Emri i funksionit	Nr. i dhomave	Persona për dhomë	Hapësira neto për dhomë	Hapësira neto për dhomë	Hapësira neto për njësi funksionale
Kuzhina					
Dhomë për mbeturinat (me/pa ventilim)	2x		10.0 m ²	20.0 m ²	
Hapësira për kuzhinë për 115 të burgosur + 50 gardianë	1x		100.0 m ²	100.0 m ²	
Zyrë për llogaritjen e ushqimit, administrimi i kuzhinës dhe marrja e materialeve duke përfshirë tualetet, lavamanët, dhomën e zhveshjes – m/f	1x		15.0 m ²	15.0 m ²	
Hapësirë për parkim dhe pastrim të mjeteve të shpërndarjes së ushqimit			20.0 m ²	20.0 m ²	
Dhomë sociale dhe për ngrënie për të burgosurit që punojnë në kuzhinë	1x		15.0 m ²	15.0 m ²	
Magazina e kuzhinës	1x		60.0 m ²	60.0 m ²	
Dhomë me ftohje (magazinin i veçantë për ushqimet)	1x		20.0 m ²	60.0 m ²	
Dhoma me ftohje	1x		10.0 m ²	20.0 m ²	
Parafrigoriferimi	1x		20.0 m ²	20.0 m ²	
Shuma, kuzhina				330.0 m²	330.0 m²
Lavanderia					
Lavanderia – dhoma e lavatriçeve	1x		80.0 m ²	80.0 m ²	
Dhoma e materialeve për t'u larë	1x		30.0 m ²	30.0 m ²	
Dhoma e materialeve të pastra (që janë larë)	1x		40.0 m ²	40.0 m ²	
Magazinë për pajisjet	1x		15.0 m ²	15.0 m ²	
Dhomë sociale për të burgosurit (tualet dhe dush)	1x	7P	20.0 m ²	20.0 m ²	
Zyrë për një person (tualet/lavaman)	1x		10.0 m ²	10.0 m ²	
Shuma, lavanderia				195.0 m²	195.0 m²

Emri i funksionit	Nr. i dhomave	Persona për dhomë	Hapësira neto për dhomë	Hapësira neto për dhomë	Hapësira neto për njësi funksionale
Furra e bukës					
Dhomë pune	1x		80.0 m ²	80.0 m ²	
Dhomë me ftohje të shpejtë	1x		20.0 m ²	20.0 m ²	
Magazinë buke (për daljet)	1x		25.0 m ²	25.0 m ²	
Zyrë për një person (tualet/lavaman)	1x		10.0 m ²	10.0 m ²	
Dhomë sociale me tualet/dush për 10 të burgosurit	1x	10P	15.0 m ²	15.0 m ²	
Magazina e materialeve për prodhim	1x		20.0 m ²	20.0 m ²	
Shuma, furra e bukë				170.0 m²	170.0 m²



Emri i funksionit	Nr. i dhomave	Persona për dhomë	Hapësira neto për dhomë	Hapësira neto për dhomë	Hapësira neto për njësi funksionale
Hapësirë e përgjithshme pune e lidhur me ambientet e punës					
Ambientet e punës (përpunim metali, instalime elektrike, punë nga kompanitë private, ndarja e mbeturinave, (opsionale) për 30 të burgosur me magazinat e nevojshme; 1 dhomë të madhe, e ndarë në hapësira të tjera)	1x	30P	300.0 m ²	300.0 m ²	
Magazinë	2x		20.0 m ²	40.0 m ²	
Zyrë për ambiente të ndryshme pune (kontroll) (1 gardian)	1x		10.0 m ²	10.0 m ²	
Zyrë për kopshtarin (1 gardian)	1x		10.0 m ²	10.0 m ²	
Dhomë për menaxherin e çelësave (të ambienteve të punës dhe magazinave) (1 gardian)	1x		10.0 m ²	10.0 m ²	
Tualet për punonjësit (meshkuj/femra)	1x		15.0 m ²	15.0 m ²	
Dhomë zhveshjeje, dush dhe tualet për të burgosurit	1x		35.0 m ²	35.0 m ²	
Dhomë ndenjeje për ditën për të burgosurit (+ kopshtari)	1x	30P	10.0 m ²	10.0 m ²	
Dhoma e mbeturinave	1x		8.0 m ²	8.0 m ²	
Zyrë për çështje të tjera për 2 persona			10.0 m ²	10.0 m ²	
Shuma, ambientet e punës të lidhura				448.0 m²	448.0 m²

Institucione të përgjithshme					
Magazinë për dosjet	1x		40.0 m ²	40.0 m ²	
Ambiente ndihmese për personelin e lartë	1x		20.0 m ²	20.0 m ²	
Dhomë për pjatat për 50 punonjës	1x	50P	80.0 m ²	80.0 m ²	
Vende për lavash + garazh për makinat zyrtare	1x		18.0 m ²	18.0 m ²	
Apartamenti i drejtorit	1x		40.0 m ²	40.0 m ²	
Shuma, institucione të përgjithshme				198.0 m²	198.0 m²

Zonat për materialet dhe mbeturinat					
Mundësi për hyrje, paraoborr (të paktën (10m x15m BxL)	1x		10.0 m ²	10.0 m ²	
Ndarje (minimumi 10m x 20m/BxL) 2 Lanes	1x			75.0 m ²	
Zona e marrjes së mallit (e arritshme nga të gjitha departamentet) zona e shkarkimit për firmat që sjellin mall me lidhje për tek qe ashensori i transportit për në kaponet e punës etj. (opsionale) vend për kthesë për autobusin e të burgosurve 20m (ca 30m x 30 m)				900.0 m ²	
Dhoma e mirëmbajtjes	1x		40.0 m ²	40.0 m ²	
Dhoma e mbeturinave A+B me mundësi për zhvendosje (1x pajisje ftohëse)	2x		25.0 m ²	50.0 m ²	
Shuma e zonës për materialet dhe mbeturinat				1075.0 m²	1075.0 m²

Emri i funksionit	Nr. i dhomave	Persona për dhomë	Hapësira neto për dhomë	Hapësira neto për dhomë	Hapësira neto për njësi funksionale
Zonat e jashtme për shëtitje/zonat e lira					
3. Zonat e jashtme për shëtitje, kontrolli i përgjithshëm, një për gratë dhe të miturit, e arritshme direkt nga departamentet					
Zona e jashtme për shëtitje - paraburgim	1x	30P	250.0 m ²	250.0 m ²	
Zona e jashtme për shëtitje - jetesa në grup	1x	10P	100.0 m ²	100.0 m ²	
Zona e jashtme për shëtitje – të miturit	1x	7P	100.0 m ²	100.0 m ²	
Zona e jashtme për shëtitje - departamenti i spitalit	1x	5P	50.0 m ²	50.0 m ²	
Zona e jashtme për shëtitje - gratë	1x	3P	40.0 m ²	40.0 m ²	
Kopsht me market	1x		100.0 m ²	100.0 m ²	
Zona e jashtme për vizitorët	1x		50.0 m ²	50.0 m ²	
Shuma e zonës së jashtme për shëtitje/zonat e lira				690.0 m²	690.0 m²
Vend për parkim makinash					
Vend për parkim për punonjësit	50x				



Vend për parkim për vizitorët	30x				
Shuma, vende për parkim makinash	80x				

Emri i funksionit	Njësia
Seksioni i meshkujve	1101 m ²
Seksioni i meshkujve, dhoma për ndenje në grup	279 m ²
Seksioni i grave, dhoma për ndenje në grup	43 m ²
Seksioni i të miturve	197 m ²
Seksioni i spitalit	238 m ²
Institucionet e përbashkëta (fetare, edukimit etj.)	130 m ²
Palestra e gjimnastikës dhe e sporteve	150 m ²
Dhoma qendrore e gardianëve	211 m ²
Dhoma hyrëse për kontrollin e vizitorëve.	60 m ²
Salla e qëndrimit të vizitorëve dhe e informacionit	205 m ²
Zona e dhomave të marrjes në pyetje të të dënuarve	105 m ²
Ambiente të shkollimit profesional të të miturve.	195 m ²
Zyra të administratës	180 m ²
Zyra qendrore e gardianëve	65 m ²
Blloku i dhomave të ekzekutimeve penale	100 m ²
Blloku i zyrave ekonomike dhe e administratës.	65 m ²
Magazine, garazhe	295 m ²
Kuzhina	330 m ²
Lavanderia	195 m ²
Furrat e pjekjes së bukës	170 m ²
Ambiente pune të përgjithshme	448 m ²
Blloku i zyrave të institucioneve të rëndësishme	198 m ²
Zona e furnizimeve të ndryshme dhe e heqjes së mbeturinave	1075 m ²
Nëntotali i sipërfaqes së regjimit të brendshëm	6035 m²
Sipërfaqe e lirë brenda regjimit të brendshëm	690 m ²
Sipërfaqja totale e regjimit të brendshëm	6725 m²
Vende parkimi	80
Totali i zonave të mbajtjes nën mbikëqyrje të të burgosurve	115
Zona e meshkujve - paraburgim	80
Zona e meshkujve që vuajnë dënimin në qeli të përbashkët	20
Zona e grave	3
Zona e të miturve	7
Zona e spitalit	5
Kapaciteti total	115

VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I HAPËSIRËS

Emri i hapësirës	Njësia	Sasia
Hapësira nga programi funksional	m ²	6035
50% shtesë për infrastrukturë të përgjithshme (lëvizje)	m ²	3362
Nëntotali	m ²	9397
5% shtesë për zonën e murit	m ²	470
Totali për zonën e planifikuar	m ²	9867
10 % zonë e lëvizjes së brendshme/zona të lira	m ²	986
Totali i regjimit të brendshëm	m²	10853



SHTOJCA 3
PËR PAJISJEN E AMBIENTEVE, STANDARDEVE DHE MJETEVE TË SHËRBIMIT
SHËNDETËSOR

	Objektet/sendet	Sasia
Dhomë e vizitave të mjekut, S=16m ²	Krevat vizitash mjekësore	copë 1
	Tavolinë pune	copë 1
	Karrige	copë 2
	Kompiuter	copë 1
	Televizor	copë 1
	Dollap për mbajtje dokumentacioni	copë 1
Dhomë gjumi e mjekut me S=16m ²	Krevat fjetjeje	copë 1
	Tavolinë	copë 1
	Karrige	copë 1
	Kompiuter	copë 1
	Televizor	copë 1
	Frigorifer	copë 1
	Rafte librash	copë 1
	Dollap gardërobë	copë 1
Aneksi i dhomës (tualeti) me S= 4 m ²	Lavaman	copë 1
	Banjë	copë 1
	Bide	copë 1
	Dush	copë 1
	Kosh plehrash	copë 1
Dhomë mjekimi e infermierëve me S=16 m ²	Krevat vizitash mjekësore	copë 2
	Tavolinë mjekimi	copë 1
	Tavolinë pune	copë 1
	Karrige	copë 2
	Dollap për mbajtje urgjence	copë 1
Dhomë gjumi e infermierëve me S=16 m ²	Krevat fjetjeje	copë 1
	Tavolinë	copë 1
	Karrige	copë 2
	Kompiuter	copë 1
	Televizor,	copë 1
	Frigorifer	copë 1
	Rafte librash	copë 1
	Dollap gardërobë	copë 1
Aneksi i dhomës (tualeti) me S=4 m ²	Lavaman	copë 1
	Banjë	copë 1
	Bide	copë 1
	Dush	copë 1
	Kosh plehrash	copë 1
Dhomë farmacie me S= 16 m ²	Të gjitha pajisjet që duhen për funksionimin e një farmacie	
Aneksi i farmacisë (tualeti) me S=4 m ²	Lavaman	copë 1
	Banjë	copë 1
	Bide	copë 1
	Dush	copë 1
	Kosh plehrash	copë 1
Dhomë e Promocionit dhe Psikologes me S=16 m ²	Tavolinë pune	copë 1
	Karrige	copë 6
	Kompiuter	copë 1
	Televizor	copë 1
	Rafte librash	copë 1
	Dollap gardërobë	copë 1
Dhomë e aparaturave mjekësore me S= 24 m ²	Aparat Rongeni (Scopi dhe Grafi) Echo Abdominale	



Dhomat e shtrimeve ditore me S= 16 m ² (për dy persona)	Krevat fjetje	copë 2
	Tavolinë	copë 1
	Karrige	copë 2

SHTOJCA 4 VLERAT E NDRIÇIMIT SIPAS AMBIENTEVE

Garazhet	100 lux
Ambienti i pajisjeve teknologjike	100 lux
Pajisjet teknologjike zona e shpërndarjes	200 lux
Magazinë për sende të forta	100 lux
Magazinë	200 lux
Korridoret shkallët	200 lux
Zyrat	500 lux
Qelitë e burgimit	200 lux
Zonat e lëvizjes	50 lux
Zona ekonomike	50 lux
Zona sportive	30 lux
Zona e paraalarmit dhe alarmit	100 lux

SHTOJCA 5 PARAMETRAT E TEKNOLOGJISË MSR SIPAS AMBIENTEVE

Emri i hapësirës	Temperatura e dhomës në gradë celsius	Ventilimi mekanik LË/H	Prurja e ajrit dhe e ajrit të ndotur
Gardëroba	24	4	
Dhoma e doktorit	24	-	-
Zyrat	20	-	-
Dhomë ndenjeje, sporti, kompjuteri	20	-	-
Dhomë larjeje	20	6	
Lavanderia	20	4	
Dhomë trajnimit	20	2	
Magazinë	18	1	
Bodrum	15	1	
Tualet	18	4	-
Dushet	24	6	-
Dhoma e fesë multifunksionale	20	3	
Zona e gjimnastikës	20	2	
Dhoma e mbeturinave	E pangrohur	20	Vetëm ajër të ndotur
Dhoma e mbetjeje	15	4	-
Dhoma e kompjuterit	E pangrohur	Sipas standardeve	Vetëm ajër të ndotur
Zyrë	20	1	
Dhoma e hetimit	20	2LË	
Dhoma e pritjes e vizitorëve	20	1	
Ekzaminimi	20	1	
Dhomë sociale	20	2	
Kapanon pune	18	Makineri/siphoning	-
Dhomë kontrolli personal	22	2	
Kuzhina	20	Sipas standardeve	
Zona e magazinimit të ftohtë	-	Zonë ftohëse	-
Mensa	20	4	
Hyrja e godinës	20	1	
Dhomë e përbashkët	20	2	
Dhoma e aktiviteteve sociale	15	-	-
Në dhoma	-	Ventilim mekanik	-

**VENDIM****Nr. 283, datë 29.4.2022****PËR MASAT MENAXHUESE TË
RUAJTJES SË BURIMEVE PESHKORE
DHE PËRFSHIRJEN E
INSTITUCIONEVE NË MARRJEN DHE
ZBATIMIN E TYRE¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Marrja e masave menaxhuese të ruajtjes së burimeve peshkore ka për qëllim:

a) ruajtjen e burimeve biologjike detare dhe menaxhimin e peshkimit e të flotës, që shfrytëzon këto burime;

b) të sigurojë që peshkimi të jetë ekologjikisht i qëndrueshëm në planin afatgjatë dhe të menaxhohet në mënyrë që të jetë në përputhje me objektivat e arritjes së përfitimeve ekonomike, sociale dhe të punësimit e të kontribuojë në disponueshmërinë e furnizimit me ushqim;

c) të zbatojë qasjen e kujdesshme në menaxhimin e peshkimit dhe të sigurojë që shfrytëzimi i burimeve biologjike të gjalla detare të rikthejë dhe të mbajë popullatat e specieve të peshkuara mbi nivelet e afta për të prodhuar rendimentin maksimal të qëndrueshëm;

ç) të zbatojë qasjen e bazuar në ekosistem për menaxhimin e peshkimit për të siguruar që aktivitetet e peshkimit të kenë një ndikim negativ minimal në ekosistemet detare dhe të sigurojë që peshkimi të shmangë degradimin e mjedisit detar;

d) që, gradualisht, të eliminojë hedhurinat, rast pas rasti, duke marrë parasysh mendimet më të mira shkencore të disponueshme, duke shmangur e zvogëluar, për aq sa është e mundur, zëniet

aksidentale dhe duke siguruar gradualisht që zëniet të zbarkohen;

dh) nëse është e nevojshme, të shfrytëzojë sa më mirë zëniet aksidentale, pa krijuar një treg për këto zënie, që janë nën madhësinë minimale të ruajtjes së referencës;

e) të krijojë kushtet e nevojshme për të bërë sektorin e zënies e të përpunimit dhe aktivitetet në tokë të lidhura me aktivitetet e peshkimit ekonomikisht të qëndrueshëm dhe konkurrues;

ë) të parashikojë masa për të përshtatur kapacitetin e peshkimit të flotës në nivelet e mundësive të peshkimit, në përputhje me shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij vendimi, në mënyrë që flota të jetë ekonomikisht e qëndrueshme, pa mbishfrytëzuar burimet biologjike detare;

f) të kontribuojë në sigurimin e një standardi të drejtë jetese për ata që varen nga aktivitetet e peshkimit, duke marrë parasysh peshkimin bregdetar dhe aspektet socio-ekonomike;

g) të kontribuojë në një treg të brendshëm efikas e transparent për produktet e peshkimit dhe të sigurojë kushte të barabarta për tregtimin e tyre brenda vendit;

gj) të marrë parasysh interesat e konsumatorëve dhe të prodhuesve;

h) të promovojë aktivitetet e peshkimit bregdetar, duke marrë parasysh aspektet socio-ekonomike;

i) të harmonizojë veprimet e masat për menaxhimin e burimeve peshkore me vendimmarrjet për ruajtjen e specieve, habitateve dhe zonave të mbrojtura detare;

j) të promovojë mbështetjen e iniciativave për rritjen e vlerës së shtuar të produkteve të peshkimit në shkallë të vogël; optimizimi i kanaleve të shpërndarjes, nxitja e zënieve më pak të tregtueshme, ekoetiketimi për produktet e qëndrueshme të peshkimit në shkallë të vogël, informimi dhe ndërgjegjësimi në radhët e konsumatorëve.

2. Masat për ruajtjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve biologjike detare përfshijnë:

a) objektivat specifike për ruajtjen e shfrytëzimin e qëndrueshëm të rezervave dhe masat përkatëse, që synojnë minimizimin e ndikimit të peshkimit në mjedisin detar;

¹ Ky vendim përafron pjesërisht:

Rregulloren (BE) nr. 1380/2013, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 11 dhjetor 2013, mbi politikën e përbashkët të peshkimit, që ndryshon rregulloret e Këshillit (KE) nr. 1954/2003 dhe (KE) nr. 1224/2009 dhe që shfuqizon rregulloret e Këshillit (KE) nr. 2371/2002 dhe (KE) nr. 639/2004 dhe vendimin e Këshillit 2004/585/KE; Celex nr. 32013R1380, Fletore Zyrtare e BE-së, L 354, 28.12.2013, f. 22–61.



b) përshtatjen e kapacitetit të peshkimit të anijeve me mundësitë e disponueshme të peshkimit;

c) stimujt, duke përfshirë ato ekonomikë si mundësitë, e peshkimit, për të promovuar metodat e peshkimit, që kontribuojnë në peshkim më selektiv, për të shmangur e zvogëluar, aq sa është e mundur, zëniet aksidentale dhe peshkimin me pak ndikim në ekosistemin detar dhe në burimet e peshkimit;

ç) fiksimin dhe alokimin e mundësive të peshkimit;

d) madhësitë minimale të referencës për ruajtjen;

dh) projektet pilot për llojet alternative të teknikave të menaxhimit të peshkimit dhe në pajisjet e peshkimit, që rrisin selektivitetin ose minimizojnë ndikimin negativ të aktiviteteve të peshkimit në mjedisin detar;

e) pajtueshmërinë me detyrimet, sipas legjislacionit të brendshëm mjedisor, duke përfshirë planet e menaxhimit dhe planet e veprimit për ruajtjen e specieve.

3. Masat teknike përfshijnë:

a) karakteristikat e mjeteve të peshkimit dhe rregullat që rregullojnë përdorimin e tyre;

b) specifikimet lidhur me ndërtimin e mjeteve të peshkimit, duke përfshirë:

i. modifikimet ose pajisjet shtesë, që synojnë përmirësimin e selektivitetit ose minimizimin e ndikimit negativ në ekosistem;

ii. modifikimet ose pajisjet shtesë për të zvogëluar zëniet aksidentale të specieve të rrezikuara, të kërcënuara e të mbrojtura dhe për të zvogëluar zëniet e tjera aksidentale.

c) kufizimet ose ndalimet në përdorimin e mjeteve të caktuara të peshkimit, dhe në aktivitetet e peshkimit, në zona ose periudha të veçanta;

ç) ndërprerjen e aktiviteteve të peshkimit nga anijet e peshkimit në një zonë të caktuar për një periudhë minimale të përcaktuar, në mënyrë që të mbrohen grumbullimet e përkohshme të specieve të rrezikuara, rezervat e peshkut në riprodhim, peshqit nën madhësinë e referencës minimale të ruajtjes dhe burimet e tjera detare të cenueshme;

d) zvogëlimin e ndikimit negativ të aktiviteteve të peshkimit në biodiversitetin detar dhe ekosistemet detare, përfshirë masat që synojnë shmangien dhe zvogëlimin, aq sa është e mundur, të zënieve aksidentale;

dh) detyrimin e zbarkimit të specieve, për të cilat janë përcaktuar dimensionet minimale, sipas shtojcës III, të vendimit nr. 402, datë 8.5.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masave menaxhuese për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve peshkore në det”, të ndryshuar, të kryera gjatë aktiviteteve të peshkimit në ujërat territoriale shqiptare ose nga anijet e peshkimit me flamur shqiptar jashtë ujërave territoriale shqiptare.

4. Zbatimi i masave të parashikuara në pikat 2 dhe 3, të këtij vendimi, sigurohet nga:

a) institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës;

b) Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, në rastin e peshkimit në zonat e mbrojtura detare e bregdetare.

5. Objektivat që duhet të arrihen nga zbatimi i një plani shumëvjeçar menaxhimi të peshkimit përcaktohen në pikën 1 të këtij vendimi.

6. Planit shumëvjeçar i menaxhimit të peshkimit hartohet duke iu referuar masave të parashikuara në pikat 2 dhe 3 të këtij vendimi.

7. Planet shumëvjeçare të menaxhimit të peshkimit hartohen nga ministri përgjegjës për peshkimin në bashkëpunim me institucionin përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës.

8. Me përjashtim të pikës 7, të këtij vendimi, hartimi dhe miratimi i planeve të menaxhimit të peshkimit në zonat e mbrojtura detare e bregdetare bëhet nga ministria përgjegjëse për peshkimin në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për zonat e mbrojtura, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

9. Në rastin kur ministria përgjegjëse për peshkimin e vlerëson të nevojshme, në hartimin e planeve shumëvjeçare të menaxhimit të peshkimit përfshihen edhe institucionet teknike e shkencore.

10. Planet shumëvjeçare miratohen si çështje prioritare në bazë të mendimeve shkencore, teknike dhe ekonomike, që përmbajnë masa për ruajtjen dhe që synojnë rivendosjen e ruajtjen e rezervave të peshkut mbi nivelet e afta për të prodhuar rendimentin maksimal të qëndrueshëm, sipas shkronjës “c”, të pikës 1, të këtij vendimi.

11. Në rast se nuk është e mundur të përcaktohen objektivat specifike në lidhje me rendimentin maksimal të qëndrueshëm, sipas shkronjës “c”, të pikës 1, të këtij vendimi, për shkak të të dhënave të pamjaftueshme, planet shumëvjeçare parashikojnë masa të bazuara në



qasjen e kujdesshme në menaxhimin e peshkimit, të cilat sigurojnë të paktën një nivel të krahasueshëm të mbrojtjes së rezervës peshkore në fjalë.

12. Planet shumëvjeçare kanë të bëjnë me:

a) një specie të vetme; ose

b) në rastin e peshkimit të shumë specieve, kur dinamika e rezervave kryqëzohet, me aktivitetin e peshkimit, që shfrytëzon rezervat e ndryshme në një zonë gjeografike në fjalë, duke marrë parasysh njohuritë mbi ndërveprimet midis rezervave të peshkut, peshkimit dhe ekosistemeve detare.

13. Planet shumëvjeçare përmbajnë objektiva specifike të ruajtjes dhe masa konservimi të bazuara në qasjen pro ekosistemit, në mënyrë që të adresojnë problemet specifike të peshkimit të shumë specieve në lidhje me arrijtjen e objektivave të përcaktuar sipas shkronjës “c”, të pikës 1, të këtij vendimi, për disa stoqe të përfshira në plan dhe nëse këshillimi shkencor tregon se është e pamundur të rritet selektiviteti.

14. Aty ku është e nevojshme, plani shumëvjeçar përfshin masa alternative specifike të mbrojtjes për disa nga rezervat e përfshira në plan, bazuar në qasjen pro ekosistemit.

15. Një plan shumëvjeçar i peshkimit parashikon gjithashtu mundësinë e rishikimit të tij pas vlerësimit paraprak të ndryshimeve të mendimeve shkencore.

16. Ngarkohen ministria përgjegjëse për peshkimin, ministria përgjegjëse për mjedisin, institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës dhe institucioni përgjegjës për zonat e mbrojtura për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

VENDIM
Nr. 284, datë 29.4.2022

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE,
PROCEDURAVE DHE KRITEREVE PËR
PAJISJEN ME CERTIFIKATËN E
EKSPERTIT NË FUSHËN E PYJEVE
DHE KULLOTAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 19, të ligjit nr. 57/2020, “Për

pyjet”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka për qëllim përcaktimin e rregullave, procedurave dhe kriterëve për pajisjen me certifikatë të ekspertëve në fushën e pyjeve dhe kullotave, në përputhje me veprimtaritë që kërkojnë shërbimin e ekspertizës profesionale në pyje dhe kullota.

2. Pajisja me certifikatën e ekspertit në fushën e pyjeve është e detyrueshme për çdo individ, që kërkon të ushtrojë ekspertizë profesionale për veprimtari të tilla, si supervizimi, studimi, projektimi dhe zbatimi për investimet në pyje dhe kullota në Republikën e Shqipërisë me fonde publike e private.

3. Në kuptim të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) **“Aplikim elektronik”**, kërkesa e dorëzuar nëpërmjet portalit qeveritar “*e-Albania*”, për pajisjen me certifikatën e ekspertit në fushën e pyjeve dhe dorëzimi i dokumenteve që shoqërojnë kërkesën.

b) **“Certifikatë”**, dokumenti zyrtar i lëshuar nga ministri përgjegjës për pyjet në përputhje me kërkesat e këtij vendimi, pas plotësimit të kriterëve të certifikimit.

c) **“Certifikimi i ekspertit në fushën e pyjeve”**, ka kuptimin sipas pikës 1, të kreut III, të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar.

ç) **“Ekspert i certifikuar”**, ka kuptimin e dhënë sipas pikës 13, të nenit 3, të ligjit nr. 57/2020, “Për pyjet”.

d) **“Specialist i mesëm”**, individ që ka përfunduar studimet dhe është certifikuar dhe/apo diplomuar, referuar përkatësisht niveleve 4 e 5, të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, miratuar me ligjin nr. 10247, datë 4.3.2010, “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve”, të ndryshuar, në institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional.

dh) **“Veprimtari”**, ka kuptimin e dhënë sipas ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për lejet, licencat



dhe autorizimet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

4. Termat “cikël studimi”, titujt akademikë “Profesor” dhe “Profesor i asociuar”, të përdorur në këtë vendim, kanë të njëjtin kuptim me përkufizimet e dhëna në ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

II. RREGULLAT PËR CERTIFIKIMIN E EKSPERTIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

1. Certifikimi i ekspertit në fushën e pyjeve dhe kullotave kryhet nga struktura përgjegjëse për pyjet në ministri, nëpërmjet aplikimit elektronik në portalin qeveritar “*e-Albania*”.

2. Kërkuesi aplikon në portalin “*e-Albania*” për marrjen e certifikatës si ekspert për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimeve të ekspertizës profesionale në fushën e pyjeve dhe kullotave.

3. Shërbimi i ekspertizës profesionale në pyje dhe kullota ushtrohet nga eksperti për veprimtaritë e mëposhtme:

a) supervizimin e aktiviteteve të ndryshme në fushën e pyjeve dhe kullotave, mbikëqyrjen, kolaudimin dhe certifikimin e veprimtarive të prodhimit apo tregtimit të farave, kalemave e fidanëve pyjorë dhe të materialit mbjellës;

b) hartimin e metodikave, udhëzuesve/manualeve, studimeve thellësisht teknike për përdorimin e territorit për zhvillimin e qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kullor dhe vlerësimin e peizazhit, biodiversitetit, zonave të mbrojtura dhe parqeve kombëtare, florës spontane (bimët mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore), faunës së egër, të rrjetit të burimeve gjenetike, konservimit të germoplazmës dhe parandalimit të rrezikut të zjarreve;

c) hartimin e projekteve të tilla, si projekte komplekse të menaxhimit të pellgjeve ujëmbledhëse, projekte për hartimin e planeve të mbarështimit të pyjeve, kullotave, florës dhe faunës, për pyllëzimet, fidanishtet, trajtimin e pyjeve me prerje kulturore, të sistemimeve malore, përmirësimit të kullotave dhe veprave ujëpirëse në to, të mbritshmërisë, ndërtimin e rrugëve autopjore dhe teleferikëve pyjorë;

ç) zbatimin e projekteve në fushën e pyjeve, ku përfshihet zbatimi i projekteve të shfrytëzimit, të

pyllëzimit dhe projektet që dalin në zbatim të objektivave të planit të mbarështimit të pyjeve.

4. Certifikimi i ekspertit kryhet nga ministria përgjegjëse për pyjet, pas verifikimit të plotësimit të kriterëve të certifikimit dhe të dokumentacionit përkatës, të përcaktuara sipas këtij vendimi. Individët, që kanë dorëzuar kërkesë për certifikim, nuk i nënshtrohen testimit të njohurive për marrjen e certifikatës së ekspertit.

5. Tarifa e aplikimit për pajisjen me certifikatën e ekspertit në pyje është 2 000 (dy mijë) lekë. Kjo tarifë depozitohet në llogarinë e ministrisë përgjegjëse për pyjet dhe kullotat, në degën e thesarit ose/dhe elektronikisht përmes platformës qeveritare të pagesave elektronike. Të ardhurat e përfituara prej tyre derdhen në buxhetin e shtetit.

6. Certifikata e ekspertit në fushën e pyjeve dhe kullotave miratohet nga ministri përgjegjës për pyjet, në përputhje me parashikimin e pikës 5, të nenit 19, të ligjit nr. 57/2020, “Për pyjet”.

7. Lista e ekspertëve të certifikuar sipas shërbimeve të ekspertizës profesionale që ata ofrojnë publikohet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për pyjet e kullotat dhe përditësohet çdo fillim muaji nga struktura përgjegjëse për pyjet e kullotat në ministri.

III. KRITERET PËR PAJISJEN ME CERTIFIKATË

1. Për pajisjen me certifikatën e ekspertit në fushën e pyjeve e kullotave për veprimtaritë e fushës së ekspertizës profesionale, të parashikuara në shkronjat, “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 3, të kreut II, të këtij vendimi, kërkuesi duhet të mos ketë qenë i dënuar me burgim për vepra penale të kryera me dashje, si dhe duhet të plotësojë një nga kriteret e mëposhtme:

a) Të ketë fituar titujt akademikë, “Profesor i Asociuar” ose “Profesor” në fushën e pyjeve dhe kullotave; ose

b) Në rast se kërkuesi nuk plotëson kriterin sipas shkronjës “a”, të pikës 1, ai duhet:

i. të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve në fushën e pyjeve dhe kullotave, sipas nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, dhe të ketë të paktën 15 vjet eksperiencë në punë në fushën e pyjeve dhe kullotave; ose

ii. të ketë përfunduar ciklin e tretë të studimeve në fushën e pyjeve dhe kullotave, sipas nivelit 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, dhe të ketë të



paktën 10 (dhjetë) vjet eksperiencë në punë në fushën e pyjeve dhe kullotave.

2. Për pajisjen me certifikatën e ekspertit vetëm për shërbimet e ekspertizës profesionale në pyje dhe kullota, të parashikuara në shkronjat “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 3, të kreut II, të këtij vendimi, kërkuesi duhet të plotësojë në mënyrë kumulative kriteret e mëposhtme:

a) Të ketë përfunduar studimet në programin e ciklit të tretë të studimeve në fushën e pyjeve dhe kullotave, referuar nivelit 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, dhe të ketë të paktën 3 (tre) vite eksperiencë në punë në fushën e pyjeve dhe kullotave ose të ketë përfunduar studimet në programin e ciklit të dytë të studimeve në fushën e pyjeve dhe kullotave, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, dhe të ketë të paktën 7 (shtatë) vite eksperiencë në punë në fushën e pyjeve dhe kullotave;

b) Të mos ketë qenë i dënuar me burgim për vepra penale të kryera me dashje.

3. Për pajisjen me certifikatën e ekspertit vetëm për veprimtaritë në fushën e shërbimeve të ekspertizës profesionale në pyje dhe kullota, të parashikuara në shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 3, të kreut II, të këtij vendimi, kërkuesi duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të ketë përfunduar studimet në programin e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve në fushën e pyjeve, referuar përkatësisht niveleve 6 dhe 7, të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve;

b) të ketë të paktën 5 (pesë) vite eksperiencë në punë në fushën e pyjeve dhe kullotave;

c) të mos ketë qenë i dënuar me burgim për vepra penale të kryera me dashje.

4. Për pajisjen me certifikatën e ekspertit vetëm për veprimtarinë e shërbimeve profesionale në pyje dhe kullota, të parashikuara në shkronjën “ç”, të pikës 3, të kreut II, të këtij vendimi, kërkuesi duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të jetë specialist i mesëm për pyjet, sipas përcaktimit të shkronjës “d”, të pikës 3, të kreut I, të këtij vendimi;

b) të ketë të paktën 2 (dy) vite eksperiencë në punë në fushën e pyjeve dhe kullotave;

c) të mos ketë qenë i dënuar me burgim për vepra penale të kryera me dashje.

IV. PROCEDURAT PËR PAJISJEN ME CËRRFATË TË EKSPERTIT TË PYJEVE DHE SHFUQIZIMIN E CERTIFIKATËS

1. Kërkuesi aplikon në portalin qeveritar “e-Albania”, duke plotësuar formularin e aplikimit, i cili përmban të dhënat e përcaktuara në lidhjen nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi, me dokumentet e mëposhtme:

a) dokumentin origjinal të skanuar, që provon eksperiencën e punës së kërkuar në fushën e pyjeve apo kullotave (librezë pune);

b) dëshminë e penalitetit, të lëshuar jo më herët se tre muaj nga data e paraqitjes së dokumentit, që sigurohet nga punonjësi i institucionit shërbimofrues;

c) faturën (mandat arkëtimi) që provon se ka paguar tarifën e parashikuar në pikën 5, të kreut II, të këtij vendimi;

ç) dokumentin origjinal të skanuar të titullit të fituar “Profesor” apo “Profesor i Asociuar” në fushën e pyjeve dhe kullotave, ose diplomë që provon se ka përfunduar ciklin e dytë ose të tretë të studimeve në fushën e pyjeve dhe kullotave, referuar përkatësisht niveleve 7 ose 8, të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, për të gjithë individët që kërkojnë të pajisen me certifikatën e ekspertit në fushën e pyjeve dhe kullotave për veprimtaritë e fushës së ekspertizës profesionale, të parashikuara në shkronjat, “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 3, të kreut II, të këtij vendimi;

d) dokumentin origjinal të skanuar të diplomës, që provon se kërkuesi ka përfunduar studimet në programin e ciklit të dytë ose të tretë të studimeve, referuar përkatësisht nivelit 7 ose nivelit 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, për të gjithë kërkuesit që aplikojnë për t’u pajisur me certifikatën e ekspertit në fushën e pyjeve dhe kullotave vetëm për shërbimet e ekspertizës profesionale në pyje dhe kullota, për veprimtaritë e fushës së ekspertizës profesionale, të parashikuara në shkronjat “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 3, të kreut II, të këtij vendimi;

dh) dokumentin origjinal të skanuar të diplomës, që provon se kërkuesi ka përfunduar studimet në programin e ciklit të parë ose të ciklit të dytë të studimeve, referuar përkatësisht niveleve 6 dhe 7, të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, për të gjithë kërkuesit që aplikojnë për t’u pajisur me certifikatën e ekspertit në fushën e pyjeve dhe kullotave për veprimtaritë e fushës së ekspertizës



profesionale, të parashikuara në shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 3, të kreut II, të këtij vendimi;

e) dokumentin origjinal të skanuar të diplomës së Maturës Shtetërore Profesionale, e lëshuar në përfundim të programit të shkollës së mesme profesionale në profilin “pyje”, referuar përkatësisht nivelit IV të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), dhe/ose certifikatë profesionale të niveleve 4 dhe 5, të KSHK-së, që provon se kërkuuesi ka përfunduar me sukses kualifikimin profesional për pyjet dhe kullotat, për të gjithë kërkuuesit që aplikojnë për t’u pajisur me certifikatën e ekspertit në fushën e pyjeve dhe kullotave, vetëm për ekspertizën profesionale në pyje dhe kullota, për veprimtaritë e fushës së ekspertizës profesionale, të parashikuara në shkronjën “ç”, të pikës 3, të kreut II, të këtij vendimi.

2. Struktura përgjegjëse për pyjet në ministri, brenda 15 ditëve pune nga data e paraqitjes së kërkesës, shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin e depozituar nga kërkuuesi, si dhe verifikon nëse dokumentacioni është depozituar i plotë sipas pikës 1, të këtij kreu.

3. Në rast se gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat pranë ministrisë konstaton se dokumentacioni i depozituar sipas pikës 1, të këtij kreu, nuk është i plotë apo nuk është sipas formatit të kërkuar, njofton përmes portalit *e-Albania* kërkuuesin, duke kërkuar plotësimin e dokumentacionit dhe të metave të konstatuara, brenda 7 (shtatë) ditëve nga dita e njoftimit.

4. Mosplotësimi i dokumentacionit të kërkuar brenda afatit të përcaktuar në pikën 3, të këtij kreu, përbën shkak për mospranimin e kërkesës. Kërkuuesi njoftohet përmes portalit *e-Albania* për arsyet e refuzimit, si dhe për të drejtën e ankimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ankimet administrative.

5. Struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në ministri, nëse vlerëson se dokumentacioni është i plotë sipas pikës 1, të këtij kreu, dhe plotëson kriteret e përcaktuara në kreun III, brenda 5 (pesë) ditëve, i përcjell ministrit certifikatën së bashku me argumentet për pajisjen e kërkuarit me certifikatë ekspert, sipas veprimtarive në fushën e shërbimit të kërkuar të ekspertizës profesionale në pyje dhe kullota.

6. Ministri miraton kërkesën dhe nënshkruan elektronikisht certifikatën e ekspertit për të ushtruar veprimtarinë apo veprimtaritë që përshkruhen në certifikatë, sipas formatit të miratuar prej tij.

7. Struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në ministri, në rast se konstaton se dokumentet e paraqitura nga eksperti janë të pavërteta apo vihet në dijeni nga strukturat monitoruese kontrolluese/inspektuese se eksperti ka shkelur kërkesat e legjislacionit në fuqi për pyjet i propozon ministrit, brenda 5 (pesë) ditëve nga konstatimi apo vënia në dijeni, shfuqizimin e certifikatës.

8. Ministri miraton propozimin dhe nënshkruan urdhrin përkatës për shfuqizimin e certifikatës së ekspertit.

9. Struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në ministri njofton nëpërmjet portalit qeveritar *e-Albania* brenda 3 (tre) ditëve kërkuuesin për urdhrin e ministrit me objekt shfuqizimin e certifikatës dhe arsyet shfuqizimit, si dhe përditëson regjistrin e ekspertëve të pyjeve, të publikuar në faqen zyrtare të ministrisë.

10. Kërkuuesi ka të drejtën e ankimit administrativ për shfuqizimin e certifikatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ankimet administrative.

V. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ekspertët e certifikuar në fushën e pyjeve dhe kullotave, përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij, përmes portalit *e-Albania*, dorëzojnë certifikatën e ekspertit që disponojnë, së bashku me dokumentacionin që plotëson kriteret e përcaktuara në këtë vendim për t’u pajisur me certifikatën e ekspertit sipas formatit të miratuar nga ministri, në përputhje me pikën 5, të nenit 19, të ligjit nr. 57/2020, “Për pyjet”. Procedura për pajisjen me certifikatën e ekspertit është e njëjtë me atë të parashikuar në kreun IV, të këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj



Lidhja nr. 1

Formulari i kërkesës

Tiranë, më / /

Shkruaj me germa kapitale **EMËR MBIEMËR**

Kërkoj të certifikohem si ekspert për të kryer shërbimin e ekspertizës profesionale në pyje dhe kullota në veprimtarinë/veprimtaritë, sipas përcaktimeve:

a) ☐ supervizimin e aktiviteteve të ndryshme në fushën e pyjeve dhe kullotave, mbikëqyrjen, kolaudimin dhe certifikimin e veprimtarive të prodhimit apo tregtimit të farave, kalemave e fidanëve pyjor dhe të materialit mbjellës.

b) ☐ hartimin e metodikave, udhëzuesve/manualeve, studime thellësisht teknike për përdorimin e territorit, për zhvillimin e qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kullor dhe vlerësimin e peizazhit, biodiversitetit, zonat e mbrojtura dhe parqet kombëtare, florën spontane (bimët mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore), faunën e egër, të rrjetit të burimeve gjenetike, konservimit të germoplazmës dhe parandalimit të rrezikut të zjarreve.

c) ☐ hartimin e projekteve të tilla si, projekte komplekse të menaxhimit të pellgjeve ujëmbledhës, projekte për hartimin e planeve të mbarështimit të pyjeve, kullotave, florës dhe faunës, për pyllëzimet, fidanishtet, trajtimin e pyjeve me prerje kulturore, të sistemeve malore, përmirësimit të kullotave dhe veprave ujëpëruese në to, të mbritshmërisë, ndërtimin e rrugëve auto pyjore dhe teleferikëve pyjorë.

ç ☐ zbatimin e projekteve në fushën e pyjeve (zbatimi i projekteve të shfrytëzimit, të pyllëzimit) dhe të projekteve të tjera që dalin në zbatim të objektivave të planit të mbarështimit të pyjeve.

V.O. (Plotësoni kutinë apo kutitë në krah të fushave që kërkoheni të certifikoheni)

KUJDES! Kërkesa konsiderohet jo e plotë dhe mund të refuzohet gjatë shqyrtimit nga strukturat përkatëse për pyjet në ministri, nëse fushat për të cilat aplikoni për t'u certifikuar, nuk janë në përputhje me kriteret ligjore të përcaktuara në këtë vendim.

Deklaroj se angazhohem të njoh e të zbatoj ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi në fushën e pyjeve dhe kullotave.

Deklaroj vërtetësinë e dokumenteve provuese dhe jam në dijeni të gjitha pasojave që mund të kemi si rezultat i deklarimeve të rreme apo paraqitjes së dokumenteve të pavërteta.

Deklaroj se nuk jam i punësuar në rolin e drejtuesit teknik në asnjë subjekt tjetër, përjashtuar këtë ku po aplikoj, si dhe nuk jam në marrëdhënie pune në institucione shtetërore, aktiviteti i të cilave bie ndesh me ligjin nr. 152/2013, datë 30.5.2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore.

Lista e dokumenteve të paraqitura: **(Shëno me “X” në krah të kutisë)**

1. Tituj/diploma (dokument origjinal i skanuar në formatin “PDF”)

a. Profesor ☐ , b. Profesor i asociuar ☐ ; c. “Diploma e gradës shkencore “master” ☐

d. Diplomë “Master i shkencave” ☐ ; e. Diplomë e masterit profesional ☐

f. Diplomë e maturës shtetërore profesionale ☐

2. Jetëshkrim (CV) personale (në formatin “PDF”) ☐

3. Librezë e punës (dokument origjinal i skanuar në formatin “PDF”) ☐

4. Dëshmi penaliteti (dokument origjinal i skanuar në formatin “PDF”) ☐

5. Fatura (mandat arkëtimi) (dokument origjinal i skanuar në formatin “PDF” në rast se kjo faturë depozitohet fizikisht) ☐

**VENDIM****Nr. 285, datë 29.4.2022****PËR KRITERET E VENDOSJES DHE TË
FUNKSIONIMIT TË STACIONEVE
SEZONALE TË ANKORIMIT/
BREGËZIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 21, të ligjit nr. 43/2020, “Për aktivitetet e turizmit detar”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e kriterëve të vendosjes të stacioneve sezonale të ankorimit/bregëzimit të mjeteve lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi si dhe mënyrës së funksionimit për vendosjen e tyre, në vijën bregdetare të Republikës së Shqipërisë, sipas parashikimeve të këtij vendimi.

2. Ky vendim zbatohet:

a) nga çdo person fizik dhe juridik, vendas dhe i huaj, të cilët aplikojnë për vendosjen e stacioneve sezonale të ankorimit/bregëzimit të mjeteve lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi, nëpërmjet lidhjes së kontratës së qirasë për funksionimin e këtyre stacioneve;

b) nga çdo institucion publik i ngarkuar, i cili përfshihet në procesin e planifikimit, dhënies me qira ose përdorim dhe monitorimit të stacioneve sezonale të ankorimit/bregëzimit.

3. Stacionet sezonale të ankorimit/bregëzimit të mjeteve lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi vendosen vetëm në zonat e miratuara nga Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT-ja), sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 43/2020, “Për aktivitetet e turizmit detar”, dhe numri maksimal i stacioneve sezonale të ankorimit/ bregëzimit përcaktohet me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin, bazuar në propozimin e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit.

4. Asnjë hapësirë detare dhe sipërfaqe toke në funksion të vendosjes të stacionit sezonal të ankorimit/bregëzimit nuk mund të jepet me qira apo të vihet në dispozicion, kur bie ndesh me kontrata të lidhura apo në proces shqyrtimi, bazuar në ligjin nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në

Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, apo të vënies në dispozicion të pronës investitorëve në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit.

5. Stacioni sezonal i ankorimit/bregëzimit të mjeteve lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi plotëson kriteret e mëposhtme:

a) të përballojë në kushte sigurie, përveç peshës së tij dhe ngarkesa të tjera të përhershme, veprimet e transmetuara nga lëvizja e valëve, nga rrymat detare, nga tërheqjet gjatë ankorimit, nga erërat, nga çdo lëkundje eventuale sizmike, nga mbingarkesa vertikale të ndryshueshme dhe veprime horizontale, kushtet lokale të motit, ndryshimet në nivelin e detit, karakteristikat e mjeteve lundruese dhe mënyra e ankorimit;

b) të sigurojë dhe të marrë të gjitha masat për mbrojtjen maksimale të mjedisit detar;

c) të ketë lartësinë minimale mbi nivelin e detit 0.5 m;

ç) të ketë shërbimet higjienike të vendosura në raport 1 njësi higjienike (përbëhet nga të paktën tualete të dedikuara për femra dhe meshkuj, lavamanë dhe dush) për 25 mjete lundruese, si dhe të respektojë kriteret e parashikuara në legjislacionin në fuqi për personat me aftësi të kufizuara;

d) të sigurojë një sistem për grumbullimin e ujërave të zeza që do të gjenerohen gjatë sezonit turistik dhe të bëhet trajtimi i tyre me impiante depurimi sipas legjislacionit në fuqi;

dh) të realizojë furnizimin me energji elektrike nëpërmjet një sistemi me materiale rezistente ndaj korrozionit dhe në përputhje me rregulloret aktuale të sigurisë teknike;

e) të realizojë ndriçimin e zonës së ankorimit të mjeteve lundruese me minimumi 5-7 lux, ndërkohë ndriçimi i zonës së parkimit të mjeteve dhe karelave të realizohet minimumi me 7-10 lux;

ë) të sigurojë furnizimin me ujë në kushtet e mungesës së rrjetit të ujit të pijshëm, nëpërmjet vendosjes së depozitave për ujë të pijshëm dhe ujë industrial në raport me kapacitetin e stacionit (200 m³ ujë industrial për 200 mjete lundruese dhe 40 m³ ujë të pijshëm për 200 mjete lundruese);

f) të vendosë mjetet e sigurisë në det (kamerdare dhe litari i nevojshëm) në çdo 25 metra;

g) të instalojë sinjalistikën detare (fenerë, bova sinjalizuese, litarë lundrues kufizues, fare etj.) në përputhje me dispozitat e Kodit Detar dhe aktet



ligjore në zbatim të tij dhe me standardet specifike kombëtare dhe ndërkombëtare;

gj) të realizojë trajtimin e mbetjeve, nëpërmjet vendosjes së kontejnerëve, me një kapacitet 1.5 m³ për çdo 50 mjete lundruese. Tërheqja e mbetjeve të ngurta dhe vatore nga mjetet lundruese dhe nga kontejnerët të bëhet nga shoqëri të licencuara në zbatim të legjislacionit në fuqi;

h) Të sigurojë ndihmën e parë nëpërmjet njoftimit të mjekut të dedikuar (kontraktuar) dhe përdorimit të kasetës së emergjencës, pajisur me mjetet dhe produktet më të rëndësishme të ndihmës së parë.

6. Mënyra e funksionimit për vendosjen e stacioneve sezonale të ankorimit/bregëzimit të mjeteve lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi bëhet nëpërmjet dhënies me qira çdo personi fizik ose juridik, vendas dhe i huaj, që shfaq interes për zhvillimin e projektit për vendosjen e këtyre stacioneve nga ministria përgjegjëse për turizmin, nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Bregdetit.

7. Dhënia me qira realizohet nëpërmjet kontratës së qirasë të lidhur ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe subjektit fitues me afat deri në 10 (dhjetë) vjet sipas kontratës tip, të miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin. Subjektit fitues i ndalohej ta japë atë apo pjesë të saj të tretë me nënkontratë.

8. Tarifa minimale e dhënies me qira të sipërfaqes së truallit në funksion të stacionit sezonal të ankorimit/bregëzimit të mjeteve lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi është, në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien me qira të pasurisë së paluajtshme shtetërore.

9. Të ardhurat, që krijohen nga kontratat e qirasë apo përdorimit, të rregulluara sipas këtij vendimi, derdhen në masën 100% në buxhetin e shtetit.

10. Në rastet kur kërkohet miratimi i një lejeje ndërtimi, subjekti fitues aplikon në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

11. Dokumentacioni administrativo-ligjor për vendosjen dhe funksionimin e stacioneve sezonale të ankorimit/bregëzimit, në zbatim të këtij vendimi, përmban:

a) kërkesën për zhvillimin e veprimtarisë në hapësirën detare dhe pronën e paluajtshme shtetërore, në funksion të zhvillimit dhe

funksionimit të stacionit sezonal të ankorimit/bregëzimit;

b) ekstraktin historik, i cili gjenerohet *on-line* nga faqja e Qendrës Kombëtare të Biznesit nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe administrohet në dosjen e procedurës;

c) vërtetimin që nuk është në proces falimentimi dhe kapitalet e tij të mos jenë në proces ekzekutimi nga përbaruesit;

ç) vërtetimin se nuk është subjekt i procedurave për deklarimin e falimentimit dhe nuk ka një urdhër likuidimi të detyruar ose administrimi nga gjykata, ose të mos ketë një marrëveshje me kreditorët apo ndonjë procedurë tjetër të ngjashme;

d) dokumentin që vërteton që nuk është dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale, si person fizik ose juridik, ortak apo aksionar i shoqërisë;

dh) vërtetimin përkatës nga administrata tatimore se subjekti ka përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve, detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës.

12. Dokumentacioni teknik përmban:

a) projektidenë, në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikën 5, të këtij vendimi;

b) projektin inxhinierik në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikën 5, të këtij vendimi;

c) vlerën e investimit;

ç) planin e zbatimit, grafikun, fazat dhe afatet e realizimit të investimit.

13. Dokumentacioni financiar përmban planbiznesin, në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikën 5, të këtij vendimi, i cili të përmbajë, të paktën, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) shpenzimet kapitale për kryerjen e investimit;

b) shpenzimet për kostot operacionale dhe të ardhurat.

14. Dokumentacioni në lidhje me ndikimin mjedisor përmban impaktin mjedisor të zhvillimit të investimit dhe përmirësimet e propozuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.

15. Dokumentacioni i përcaktuar në pikat 11, 12, 13 dhe 14, të këtij vendimi, depozitohet pranë Agjencisë Kombëtare të Bregdetit.



16. Në kontratën, që do të nënshkruhet, përveç termave të përgjithshëm të kontratës duhet të mbahen parasysh:

a) natyra dhe objekti i veprimtarisë së Agjencisë Kombëtare të Bregdetit;

b) kohëzgjatja e kontratës;

c) vlera e projektit;

ç) pronësia e aseteve të projektit dhe detyrimet e palëve, sipas rastit, për dhënien me qira të hapësirës për zhvillimin e projektit dhe çdo lehtësi tjetër e mundshme;

d) tarifa e përdorimit ose qirasë;

dh) procedurat për rishikimin dhe miratimin e projekteve inxhinierike, të planeve të ndërtimit dhe specifikimeve nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit, si dhe procedurat për testimin dhe kontrollin përfundimtar, miratimin e pranimin e mjetit të infrastrukturës, rregullat e standardet, në bazë të të cilave janë projektuar projektet, që duhet të jenë në përputhje me praktikat më të mira;

e) e drejta e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit për të monitoruar zbatimin e detyrimeve të kontratës, kushtet dhe masa, në të cilën Agjencia Kombëtare e Bregdetit mund të urdhërojë ndryshime për punët dhe kushtet e shërbimit. E drejta e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit për të marrë masa të tjera të arsyeshme për të siguruar që mjeti infrastrukturor të operohet si duhet dhe shërbimet të jepen në përputhje me kërkesat e zbatueshme ligjore dhe kontraktuale;

ë) detyrimet e zhvilluesit për t'i dhënë autoritetit kontraktues apo një autoriteti tjetër publik, sipas rastit, raporte dhe informacion tjetër për veprimtarinë;

f) çdo kufizim për transferimin e të drejtave dhe të detyrimeve të zhvilluesit, sipas kontratës;

g) çdo kufizim ose kusht për transferimin e një interesi kontrollues të zhvilluesit;

gj) përkufizimi dhe pasoja e forcës madhore, ndryshimi në ligj dhe ndryshime të tjera në rrethana (duke përfshirë çdo të drejtë të palëve për të kërkuar kompensimin ose rishikimin e kontratës);

h) garancitë për t'u përmbushur dhe politikat e sigurimeve që duhet të ndiqen nga zhvilluesi për zbatimin e kontratës;

i) procedurat e rregullimit të shkeljes së kontratës, të bërë nga njëra prej palëve;

j) detyrimi i qiramarrësit për të kthyer në gjendjen fillestare e të pacenuar hapësirën tokësore dhe detare, objekt të kontratës;

k) kushtet dhe procedurat për ndryshimin dhe/ose përfundimin e kontratës;

l) ligji i zbatueshëm dhe mekanizmat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që mund të lindin ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe zhvilluesit;

ll) të drejtat dhe detyrimet e palëve për informacionin konfidencial.

17. Vlerësimi i kërkesës për zhvillimin e veprimtarisë në hapësirën detare dhe pronën e paluajtshme shtetërore, në funksion të zhvillimit dhe funksionimit të stacionit sezonal të ankorimit/bregëzimit bëhet nga një komision, i ngritur me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin. Komisioni ka në përbërje jo më pak se 5 persona, specialistë të fushës, nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Agjencia e Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme Detare, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe drejtohet nga përfaqësuesi, anëtar i Agjencisë Kombëtare të Bregdetit.

18. Në Komision nuk mund të marrin pjesë personat që kanë konflikt interesi me aplikuesit, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për konfliktin e interesit. Anëtarët e Komisionit kanë detyrimin të ruajnë konfidencialitetin e përmbajtjes së aplikimeve. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të këtij komisioni përcaktohet me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin.

19. Drejtoria e Përgjithshme Detare monitoron zbatimin e kriterëve teknike kundër ndotjeve në zbatim të konventës MARPOL dhe, në rast se konstaton shkelje, merr masë administrative në zbatim të Kodit Detar dhe akteve ligjore në zbatim të tij përkundrejt subjektit dhe i propozon njësisë përgjegjëse (AKB) plotësimin e kushteve.

20. Agjencia Kombëtare e Bregdetit pas lidhjes së çdo kontrate me subjektin investues, njofton zyrtarisht:

a) Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtorinë e Përgjithshme Detare, Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare dhe Shërbimin Hidrografik, për:

i. vendndodhjen e stacionit sezonal të ankorimit;

ii. subjektin investues;

iii. afatin e realizimit të projektit;

iv. të dhëna teknike të projektit.

b) Njësinë e vetëqeverisjes vendore në territorin ku zhvillohet aktiviteti turistik, prefektin e qarkut



dhe strukturat qendrore, në nivel vendor, si të shëndetësisë, mjedisit, furnizimit me energji elektrike.

21. Shërbimi Hidrografik përditëson në hartat detare stacionet e reja të ankorimit.

22. Drejtoria e Përgjithshme Detare informon subjektet lundruese për stacionet e reja sezonale të ankorimit/bregëzimit.

23. Policia Kufitare monitoron aktivitetin e stacioneve sezonale të ankorimit/bregëzimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

24. Përgjatë periudhës së funksionimit të stacioneve të ankorimit/bregëzimit, në territorin funksional lejohen të ofrohen vetëm:

a) shërbimi i ankorimit/bregëzimit apo parkimit të mjeteve lundruese;

b) shërbimi i ruajtjes së mjeteve;

c) shërbimi i furnizimit të pijeve dhe ushqimit.

25. Ngarkohen ministria përgjegjëse për turizmin, ministria përgjegjëse për transportin, ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike dhe Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

VENDIM
Nr. 287, datë 29.4.2022

**PËR NJË SHITESË FONDI NË
BUXHETIN E VITIT 2022, MIRATUAR
PËR MINISTRINË E KULTURËS, PËR
BASHKINË TIRANË, PËR FINANCIMIN
E PROJEKTIT “TIRANA, KRYEQYTETI
EVROPIAN I RINISË 2022”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Kulturës, në buxhetin e miratuar për vitin 2022, në zërin “Shpenzime korrente”, të programit buxhetor “Arti dhe kultura”, i shtohet fondi prej 700 000 000 (shtatëqind milionë) lekësh, për Bashkinë Tiranë, për financimin e projektit “Tirana, kryeqyteti evropian i rinisë 2022”.

2. Efekti financiar, prej 700 000 000 (shtatëqind milionë) lekësh, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i miratuar për vitin 2022.

3. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

URDHËR
Nr. 182, datë 19.4.2022

**PËR PËRCAKTIMIN E SASIVE
MINIMALE TË LEJUESHME QË MUND
TË HIDHEN NË DET PËR DISA FORMA
TË PESHKIMIT TË PELAGJIKËVE
TË VEGJËL**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të shkronjës “c”, të nenit 15, të ligjit nr. 64, datë 31.5.2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Gjatë aktivitetit të peshkimit për anijet e peshkimit që përdorin trata pelagjike dhe koshilok, lejohen të hidhen në det si hedhurina jo më shumë se 5% e zënieve totale vjetore, sipas përcaktimeve të shtojcës I, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës dhe Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca



SHTOJCA I
FORMAT E PESHKIMIT PËR PELAGJIKËT E VEGJËL NË DETIN ADRIATIK

Nënzona gjeografike sipas GFCM	Kodi i veglës të peshkimit	Vegla e peshkimit	Speciet objekt peshkimi
17 dhe 18	OTM, PTM	Trata pelagjike	Açuge, sardele, skumber, stavridh
17	PS	Koshilok	Açuge, sardele, skumber, stavridh

URDHËR
Nr. 61, datë 28.4.2022

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje dhe zbatim të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; si dhe të VKM-së nr. 395, datë 13.5.2020, “Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin, drejtorit të Negocimi dhe Asistencës Ligjore, Znj. Denada Dosti.

2. Kompetencat e titullarit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin do të ushtrohen për periudhën nga data 4.5.2022 deri më datë 6.5.2022.

3. Nuk delegohen kompetenca të padelegueshme, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet znj. Denada Dosti.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Erlis Hereni

SESIONI I TRETË
VENDIM

Kërkesa nr. 62986/09

Ardian KALIA

kundër Shqipërisë

(shih tabelën bashkëlidhur)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 10 mars 2022 si Komision, i përbërë nga:

Peeter Roosma, *kryetar*,

Andreas Zünd,

Mikhail Lobov, *gjyqtarë*,

dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendësregjistrare e përkohshme e Seksionit*,

pasi mori në konsideratë kërkesën e mësipërme të paraqitur më 26 nëntor 2009,

pasi mori në konsideratë deklaratën e paraqitur nga Qeveria e paditur, në të cilën kërkohej përjashtimi i kërkesës nga lista e çështjeve, si edhe përgjigjen e kërkuarit për këtë deklaratë,

pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

FAKTET DHE PROCEDURA

Detajet e kërkuarit paraqiten në tabelën bashkëlidhur.

Kërkuari u përfaqësua nga z. A. Hajdari, një avokat i cili e ushtron profesionin në Tiranë.

Qeverisë së Shqipërisë (“Qeverisë”) iu komunikuan ankesat e kërkuarit, bërë në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës, në lidhje me mosekzekutimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese të datës 30 prill 2001, si edhe në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave.

Qeveria paraqiti një deklaratë me qëllim zgjidhjen e problemeve të cilat ngriheshin me anë të këtyre ankesave. Në vijim, Qeveria i kërkoj Gjykatës ta përjashtonte kërkesën nga lista e saj e kërkesave.



Qeveria pranoi se në çështjen e kërkesit ishte shkelur afati i arsyeshëm sipas nenit 6 § 1 të Konventës. Qeveria e informoi Gjykatën se vendimi përfundimtar ishte ekzekutuar plotësisht me anë të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 268, i datës 15 shtator 2010, me anë të të cilit urdhërohej rikthimi i kërkesit në pozicionin e tij të mëparshëm. Qeveria ofroi t'i paguante kërkesit shumën e detajuar në tabelën bashkëngjitur dhe e ftonte Gjykatën ta përjashtonte kërkesën nga lista e çështjeve. Shuma do të konvertohej në monedhën e Shtetit të paditur në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes së pagesës dhe do të paguhej brenda tre muajve nga data e shpalljes së vendimit të Gjykatës. Nëse kjo shumë nuk do të paguhej brenda periudhës tremujore përmendur më sipër, Qeveria merrte përsipër të paguante interesin e thjeshtë për të, që nga përfundimi i asaj periudhe deri në shlyerjen e shumës, në normën e barasvlershme me normën marginale të huadhënies të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mosshlyerjes së pagesës plus tre pikë përqindje.

Shlyerja e pagesës do të përbënte zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

Kërkesi njoftoi Gjykatën se binte dakord me kushtet e deklaratës.

LIGJI

Gjykata konstaton se, pas dakordësimit të shprehur të kërkesit me kushtet e deklaratës bërë nga Qeveria, çështja duhet të trajtohet si zgjidhje miqësore midis palëve.

Për këtë arsye, ajo mban në konsideratë zgjidhjen miqësore të arritur midis palëve. Ajo gjykon se zgjidhja mbështetet në respektimin e të drejtave të njeriut sipas parashikimit në Konventë dhe në protokollet e saj, dhe nuk konstaton asnjë arsye për të justifikuar shqyrtimin e mëtejshëm të kërkesës.

Për sa më sipër, është me vend që çështja të përjashtohet nga lista.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime,

Vendos ta përjashtojë kërkesën nga lista e saj e çështjeve në mbështetje me nenin 39 të Konventës.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim, më 31 mars 2022.

Viktoriya Maradudina
Zëvendësregjistrare e
përkohshme

Peeter Roosma
Kryetar

SHTOJÇË

Kërkesë e cila parashtrohet ankesa në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës
(mosekzekutim ose vonesa në ekzekutimin e vendimeve të brendshme)

<i>Kërkesa nr. Data e paraqitjes</i>	<i>Emri i kërkesit Viti i lindjes</i>	<i>Emri dhe adresa e përfaqësuesit</i>	<i>Data e marrjes së deklaratës së Qeverisë</i>	<i>Data e marrjes së miratimit të kërkesit</i>	<i>Shuma e dhënë për dëmin jo pasuror dhe kostot dhe shpenzimet (në euro)²</i>
62986/09 26.11.2009	Ardian KALIA 1969	Hajdari Artan Tiranë	18.11.2021	10.1.2022	5,000

² Plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkesit.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 176 lekë